

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë



STRATEGJIA KOMBËTARE PËR INOVACION DHE NDËRMARRËSI (2019-2023)

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
1. HYRJE.....	5
2.1 Ndërveprimi ndërmjet inovacionit dhe ndërmarrësisë	7
2.2 Transformimi dhe mundësia për inovacion	8
2.3 Harmonizimi me strategjitë tjera kombëtare	9
3. Kushtet Kornizë për Inovacion dhe Ndërmarrësi	13
3.1 Hyrje.....	13
3.2 Gjendja aktuale në inovacion dhe ndërmarrësi.....	15
3.3 Programet aktuale të mbështetjes për inovacionin dhe ndërmarrësinë	19
3.4 Analiza SWOT.....	28
4. ÇFARË SYNON TË ARRIJË STRATEGJIA	30
5. SHTYLLAT TEMATIKE DHE OBJEKTIVAT OPERACIONAL	32
5.1 Shtylla Tematike A: Zhvillimi i një sistemi të integruar për inovacion në Republikën e Kosovës dhe avancimi i kushteve të kornizës ligjore dhe fiskale.....	33
5.2 Shtylla tematike B: Rritja e potencialit për inovacion në ndërmarrjet Kosovare.....	35
5.3 Shtylla tematike C: Mbështetja e inovacionit dhe ndërmarrësisë ndërmjet të rinjve dhe grave në biznese.....	36
5.4 Shtylla tematike D: Promovimi dhe trajtimi i inovacioneve në sektorët me potencial për zhvillim ekonomik	38
6 Prioritizimi i sektorëve të Kosovës me potencial të lartë për zhvillim ekonomik	40
7 PROCESI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË	42
7.1 Përgjegjësitë dhe Detyrat	42
Referencat.....	44
SHTOJCA.....	46

SHKURTESAT

ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
AMIK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
CEED	Qendra për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekzekutiv
COSME	Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme
EFSE	Fondi Evropian për Evropën Juglindore
PRE	Programi i Reformave Ekonomike
VSHB	Vlera e Shtuar Bruto
QK	Qeveria e Republikës së Kosovës
ICK	Qendra e Inovacionit të Kosovës
IPA	Instrumenti për Asistencë Para-anëtarësimit
ITP	Parku i Inovacionit dhe Teknologjisë
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë
IMF	Institucionet Mikrofinanciare
MIN	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
IFJB	Institucionet Financiare Jobankare
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
HZHI	Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni
SSF	Fondi i SECO për Start-Up (Bizneset fillestare)
S3	Strategjitë për Specializim të Mençur
AT	Aktivitetet Transformuese
USP	Propozimi Unik i Shitjes
WB EDIF	Mekanizmi i Zhvillimit të Ndërmarrjeve dhe Inovacionit në Ballkanin Perëndimor
BB	Banka Botërore

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në orientimin e saj afatgjatë, Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për krijimin e bazës së qëndrueshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në bazë të burimeve njerëzore dhe burimeve natyrore. Për shumë vite, Kosova e ka bazuar zhvillimin e saj ekonomik në burime natyrore, duke mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Sfidat e zhvillimit global dhe rajonal për zhvillim ekonomik janë duke u rritur dhe ekonomia tradicionale është duke pësuar ndryshime radikale.

Zhvillimi i teknologjisë industriale dhe informative, automatizimi i prodhimit dhe zhvillimi i robotikës së shërbimeve kanë shtyrë gjeneratat e reja që të riorientojnë interesat e tyre më shumë në aplikimin e teknologjisë informative dhe aplikimin e softuerit në dobi të zhvillimit ekonomik. Popullsia e Kosovës, e cilësuar si popullsia më e re në Evropë, ka kuptuar mjaft mirë dhe ka filluar aplikimin e këtyre zhvillimeve në ndërmarrjet e reja që janë duke u formuar dhe janë duke u zhvilluar shumë më shpejtë se në vendet e rajonit. Ekonomia digjitale, edhe pse është paraqitur më vonë në rajon, është duke hyrë në veprimtarinë e përditshme të ndërmarrjeve kosovare më shpejtë dhe është duke u bërë një sektor i rëndësishëm ekonomik.

Spektori i shërbimeve në fushën e teknologjisë informative është sektori i vetëm me bilanc pozitiv tregtar dhe një sektor premtues në bazë të të cilit mund të zhvillohet koncepti i mendimit të ri ekonomik në vend. Kalimi nga ekonomia tradicionale në ekonomi digjitale ka nevojë për zhvillim të një ekosistemi të inovacionit, infrastrukturës ligjore, politikave të qarta fiskale dhe sistemit efikas të arsimit nga niveli primar deri tek ai universitar.

Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi fokusohet në zhvillimin afatgjatë dhe qasjet sistematike për mbështetjen e inovacionit me ndikime ekonomike si vlerë kryesore për ekonomi të suksesshme dhe shoqëri të begata. Me këtë strategji mundësohet zhvillimi i politikave publike, infrastrukturës ligjore, politikave fiskale dhe qasja integrale e ekosistemit të inovacionit dhe ndërmarrësisë.

Nëpërmjet themelimit të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN), Qeveria e Republikës së Kosovës njeh inovacionin si veprim kryesor për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ky fakt ndërlihet me zhvillimet e fundit ekonomike globale, trendin evropian për digjitalizim të ekonomisë, globalizimin e tregjeve të produkteve dhe revolucionin e katërt industrial.

Në Strategjinë për Mbështetjen e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë përcaktohet orientimi strategjik i identifikimit të inovatorit, zhvillimit të inovacionit dhe sistemeve inovative nëpërmjet vizionit, qëllimeve strategjike dhe katër shtyllave tematike, të cilat do të përcillen me objektiva dhe plane të veprimit.

Si rrjedhojë, në qendër të aktiviteteve të propozuara të strategjisë gjendet qëllimi themelor strategjik *“ rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve kosovare dhe rritja e mirëqenies sociale është rezultat i investimit në njohuri, kreativitet dhe inovacion ”*.

1. HYRJE

Në kohën e konvergencave teknologjike në rritje dhe transformimit digjital, inovacioni dhe ndërmarrësia janë duke u bërë më të rëndësishme se asnjëherë më parë. Investimet në inovacion, hulumtim dhe zhvillim kanë dëshmuar të jenë faktorë kryesor në tejkalimin e sfidave globale ekonomike dhe sociale. Investimet në këto fusha kanë mundësuar rritjen e konkurrueshmërisë në sektorin privat, duke përmirësuar shërbimet publike dhe mirëqenien e qytetarëve.

Qeveria dhe MIN e konsiderojnë inovacionin si një fushë të rëndësishme për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe në të njëjtën kohë si ndikim direkt në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Si rrjedhojë, Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi ka për qëllim të stimulojë më tej inovacionin dhe ndërmarrësinë për Republikën e Kosovës për periudhën 2019-2023.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me nenin 3, shtojcën 20, të Rregullores (QRK) nr. 15/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe Rregulloren nr. 14/2017, në të cilën theksohet që Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është kompetente për hartimin, zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Programin e Qeverisë dhe Programin për Reforma Ekonomike dhe rekomandimet nga Raportet Ndërkombëtare Vlerësuese për Republikën e Kosovës lidhur me inovacionin dhe ndërmarrësinë, Rregullativën dhe Strategjinë e BE-së për këto dy fusha.

Strategjia është krijuar me ndihmën e burimeve të ndryshme, duke përfshirë të gjitha institucionet vendore si ministrinë e linjës, të cilat përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe në grupe punuese, pastaj në punën hulumtuese dhe shkencore në universitete, kolegje dhe institucionet shkencore dhe hulumtuese të universiteteve, informacionet dhe të dhënat nga NVM-të, start-up (bizneset fillestare), bizneset e angazhuara, organizatat jo-qeveritare që kanë për mision zhvillimin e ideve dhe aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës, odat ekonomike, konsultimet me diasporën dhe misionet e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe BE.

Vëmendje e veçantë i është dedikuar që strategjia të jetë e harmonizuar mirë me strategjitë tashmë ekzistuese apo dokumentet e ndërlidhura, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 - 2021¹ e cila i referohet zhvillimit të grupuar dhe kalimit të NVM-ve në aktivitete me vlerë më të lartë të shtuar (të gjitha me rëndësi të madhe nga strategjia aktuale) apo Strategjisë së Kosovës për TI². Në tërësi, Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi është zhvilluar duke ndjekur në mënyrë strikte udhëzimin e dhënë në Manualin për Planifikimin, Zhvillimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit³.

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 - 2012, f. 30ff http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf, qasur më 1 dhjetor 2018

² Strategjia e Kosovës për TI, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_IT_Strategy.pdf, qasur më 28 nëntor 2018

³ Manuali për Planifikimin, Zhvillimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit, 2018, ofruar nga MIN

Për më tepër, strategjia ka përfshirë filozofinë e qasjes kornizë të Strategjisë për Specializim të Mençur (Foray et al 2009), e cila luan një rol shumë të rëndësishëm në politikën evropiane për zhvillim dhe inovacion rajonal. Neni 2(3) i Rregullores së Dispozitive të Përbashkëta për Fondet Evropiane Strukturore dhe Investuese (BE, 2013) përcakton S3 si me synim “të krijimit të avantazhit konkurrues duke zhvilluar dhe përputhur përparësitë e hulumtimit dhe inovacionit me nevojat e biznesit në mënyrë që të adresohen mundësitë e paraqitura dhe zhvillimet e tregut në mënyrë koherente (fq. 338).” Në praktikë, S3 janë me rëndësi themelore për objektivin tematik të “fuqizimit të hulumtimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit” brenda kornizës së përbashkët strategjike të Fondeve Evropiane Strukturore dhe Investuese (Fondet ESI) (BE, 2013, fq. 347 ff.). Në aspektin e inovacionit dhe ndërmarrësisë, sfida për Republikën e Kosovës mbetet gjetja e ekuilibrit të duhur ndërmjet mbështetjes së të gjitha industrive kombëtare që akoma përpiqen që të bëhen inovative dhe konkurruese dhe përdorimi i burimeve të tyre të kufizuara për të shfrytëzuar mundësitë për transformim për përmbushjen e sfidave strukturore duke i kombinuar kapacitetet e tyre ekzistuese në aktivitete unike inovative (specializimi i mençur, Foray et al 2018).

Nëpërmjet Shtyllës Tematike “*Promovimi dhe trajtimi i inovacioneve në sektorët me potencial për zhvillim ekonomik*,” Strategjia Kombëtare për Inovacion dhe Ndërmarrësi radhit aktivitetet në domene me rëndësi të lartë ekonomike, të cilat duhet të përkthehen në transformime strukturore brenda ekonomisë së Republikës së Kosovës në një “proces akumulues që lidh përparësitë e tanishme dhe të ardhshme të ekonomisë kosovare.”

2 PSE DUHET TË KEMI NJË STRATEGJI PËR INOVACION DHE NDËRMARRËSI

2.1 Ndërveprimi ndërmjet inovacionit dhe ndërmarrësisë

Sipas Schumpeter, inovacioni është nxitësi kryesor strategjik për zhvillim ekonomik. Përkufizimi i inovacionit ka aspekte të ndryshme dhe fillon nga hulumtimi deri tek marketingu final, nga furnizimi deri tek konsumi, përfshirë akterët në fushën e biznesit dhe hulumtimin, si dhe përfaqësuesit qeveritar dhe civil. Për më tepër, inovacioni mund të klasifikohet në kategori të ndryshme, si inovacioni i produktit, inovacioni i procesit, inovacioni i marketingut dhe inovacioni organizativ (Elliot 2017, OECD 2018).

Ndërmarrësit marrin rolin ekzekutiv në inovacion duke rindarë burimet në mënyrë që të krijohet vlera dhe të hapen fusha të reja me produktivitet më të lartë në një proces të shkatërrimit kreativ, e cila përfshinë kohë dhe përpjekje, si dhe rreziqe financiare dhe sociale, dhe shpërblimin në fund. (Tataj 2015, Hisrich et al. 2005).

Në këtë mënyrë, ndërmarrësia është nxitja e nevojshme për lansimin e proceseve dhe stimulimin e shkëmbimit në rrjetin e inovacionit. Si katalizatore, ajo bën shtytje drejt rritjes dhe cilësisë më të lartë të produkteve dhe ndikimit. Mund të jetë një projekt në formën e idesë biznesore për rritje apo një institucion i ri qeveritar që përmirëson inovacionin e një vendi. Gjithashtu mund të ndryshojnë institucionet akademike në universitete që mendojnë dhe veprojnë në mënyrë sipërmarrëse.

Qoftë në formën tradicionale të një biznesi fillestar apo në kontekst më të gjerë, ndërmarrësia gjithmonë shoqërohet me aktivitete që përfshijnë rrezik kur ajo është kreative dhe transformon njohuritë e reja apo kuptimet e reja në inovacion. Në Ekonominë e Njohurisë në Evropë (European Knowledge Economy), ndërmarrësia është përcaktuar si thelbi i Trekëndëshit të Njohurisë, ku arsimit, hulumtimi dhe inovacioni ndërveprojnë me njëra tjetrën (shih figurën 1). Çështja kryesore është se si të përfshihet ndërmarrësia si komponent përbërës. Ndërmarrësia duhet të kuptohet si aftësia për kombinimin e qëllimshëm të pjesëve të ndryshme, nga kreativiteti deri tek inovacioni dhe tregu. Për të përfituar nga kjo aftësi dhe për të aktivizuar rrjedhat brenda Trekëndëshit të Njohurive, prioritetet duhet të përcaktohen në politika. Për shembull, një qeveri fokusohet në kapitalin njerëzor duke investuar në arsim dhe hulumtim në mënyrë që të fuqizohet konkurrueshmëria ekonomike në planin afatgjatë. Pasi që kreativiteti, inovacioni dhe konkurrueshmëria janë drejtpërdrejt të lidhura, mund të supozohet ndjekja e ciklit koherent: kreativiteti, inovacioni, ndërmarrësia, konkurrueshmëria dhe produktiviteti (Tataj 2015).




Figura 1: Ndërmarrësia dhe Trekëndëshi i Njohurive (prezantuar në bazë të Tataj 2015: 254)

2.2 Transformimi dhe mundësia për inovacion

Konvergenca teknologjike dhe transformimi digjital riformësojnë strukturat ekonomike dhe zinxhirët e vlerës në nivel rajonal në mbarë botën. Procesi gjithnjë e më dinamik i ndryshimit rezulton në shndërrimin radikal të industrive që më parë kanë qenë të suksesshme në diçka të parëndësishme dhe në të njëjtën kohë ndikon në zhvillimin e industrive të reja nëpërmjet inovacionit ndër-sektorial. Ekonomia e Republikës së Kosovës fillimisht ka qenë e karakterizuar me shfrytëzimin e burimeve natyrore. Tani, të dhënat tregojnë një rënie në sektorin e minierave në kuadër të sektorit të industrisë, ndërsa për shembull industria e përpunimit është duke u rritur (BQK 2016). Teknologjia informative, automatizimi dhe prodhimi inteligjent gjithnjë e më shumë po i zëvendësojnë strukturat tradicionale industriale. Si rrjedhojë, politikat kombëtare dhe rajonale duhet të përmirësojnë kushtet kornizë për të lehtësuar procese të tilla transformative dhe për të inkurajuar industrinë dhe akademitë që së bashku të kenë inovacion në një mënyrë të tillë. Inovacionet jo-teknike, duke përfshirë inovacionet në shërbime dhe modelet e reja biznesore, janë shtytësit kryesorë në këtë aspekt.

Në studimet dhe diskutimet e fundit lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të qasjes së specializimit të mençur është theksuar tema e aktiviteteve transformuese. Së fundi, koncepti i aktiviteteve transformuese ka baza më të qëndrueshme dhe tani përsëritet vazhdimisht në literaturën akademike: aktivitetet transformuese duhet të nënkuptohen si “mbledhje e kapaciteteve dhe veprimeve inovative që janë nxjerrë nga një strukturë apo disa struktura ekzistuese, në të cilën mund të shtohen kapacitete shtesë rajonale dhe e cila është e orientuar drejt ndryshimit të caktuar strukturor” (Foray et al 2018).

Parakushtet për menaxhimin e transformimit të domosdoshëm (përfshirë aktivitetet transformuese) nuk janë akoma të favorshme në Kosovë. Ndër të tjera, mungesa e vetëdijesimit në industri, e kombinuar me deficitet institucionale, kushtet e përmirësueshme për arsim dhe pamjaftueshmëritë infrastrukturore mund të shihen si barriera kryesore. Për më tepër, shkalla e lartë e papunësisë, në veçanti tek të rinjtë, prodhimtaria e ulët, normat e ulëta të eksportit, IHD të

kufizuara dhe pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës janë duke penguar më tej zhvillimin pozitiv ekonomik.

Remitencat paraprake nga jashtë kanë ndikuar në zhvillimin e rritjes marginale; megjithatë, do të pësojnë rënie. Për shembull, në Studimin për Remitencat në Kosovë (2012) të UNDP-së raportohet që përqindja e ekonomive familjare që kanë theksuar se remitencat janë investuar në prodhim apo aktivitetet profitabile, apo në biznes, është shumë e ulët, 4% përkatësisht 8%. Prandaj, transformimi strukturor është i nevojshëm për të “zënë trenin” e tregut global dinamik të shtyrë nga digjitalizimi dhe të mos mbetemi më shumë mbrapa. Përveç rënies në flukset hyrëse të remitencave, investimet kryesore private dhe investimet kritike publike në infrastrukturë pritet të kontribuojnë në rritje. Një sfidë kryesore do të jetë nxitja e kapaciteteve prodhuese dhe eksportuese. Avancimi i mjedisit biznesor dhe zvogëlimi i papunësisë strukturore do të jenë “vidat” e domosdoshme rregulluese (BERZH 2016.) Për të arritur këtë, duhet të zhvillohet një sistem i inovacionit që përbëhet nga masat mbështetëse fiskale dhe jofiskale për promovim ekonomik, si dhe strukturat për bashkëpunim të qëndrueshëm në të gjitha nivelet institucionale, nga administratat lokale deri tek organizatat partnere ndërkombëtare, nga ndërmjetësit rajonal të inovacionit deri tek përfaqësuesit e komunitetit të biznesit dhe hulumtimit. Në këtë kontekst, çështje kryesore do të jetë avancimi i synuar i burimeve njerëzore jo vetëm për zgjidhjen e mospërputhshmërisë ndërmjet kompetencave të punëkërkuësve në moshë të re dhe kërkesave të tregut të punës, por gjithashtu edhe zvogëlimi i papunësisë tek të rinjtë. Me programet strategjike për digjitalizim në sistemin e arsimit nëpërmjet sektorëve të ri biznesor mund të hapen perspektiva të reja për talentët e moshave të reja dhe në të njëjtën kohë mund të zvogëlohet rreziku për “largimin e trurit”. Objektivi duhet të ndërlihdet me shpalosjen e të menduarit kritik dhe shpirtit inovativ. Me kushte kornizë të përshtatshme për biznesin mund të përmbushet boshllëku nga status quo në një ekonomi konkurruese dhe të orientuar në të ardhmen.

2.3 Harmonizimi me strategjitë tjera kombëtare

Në harmoni me kornizën ligjore të Kosovës, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është kompetente për hartimin, zbatimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave, strategjive dhe legjislacionit në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.⁴ Natyra e inovacionit dhe ndërmarrësisë është ndërdisiplinore dhe përfshihet në shumë fusha të politikave. Në këtë mënyrë, më e rëndësishmja është që Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi të harmonizohet mirë me politikat tjera ekzistuese dhe të ardhshme dhe strategjitë e ndërlihdura të Qeverisë së Republikës së Kosovës, sidomos me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)⁵, Programin për Reforma Ekonomike (PRE)⁶, Strategjinë për TI, Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat në vazhdim e sipër, Raportet Ndërkombëtare Vlerësuese për Republikën e Kosovës lidhur me inovacionin dhe ndërmarrësinë dhe Rregullativën dhe Strategjinë e BE-së për këtë fushë.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021. Qeveria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim për periudhën 2016-2021 me qëllim të krijimit të bazës për rritje të qëndrueshme

⁴ Kjo strategji është hartuar në përputhje me nenin 3, shtojcën 20, sipas Rregullores (QRK) nr. 15 / 2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe Rregulloren nr. 14/2017.

⁵ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021 (qasur më 20 nëntor 2018 në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

⁶ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/57179C7A-9531-4E3D-AEDE-ECC703B75D55.pdf> (qasur më 25 nëntor 2018)

dhe gjithëpërfshirëse, si dhe për të përshpejtuar integrimin e Kosovës në BE-nëpërmjet reformave të kërkuara. Reformat kryesore që kanë për qëllim përmirësimin e mjedisit ligjor, fuqizimin e administratës publike, zhvillimin e institucioneve dhe fuqizimin e infrastrukturës fizike, duke rezultuar në përmirësimin e parakushteve të caktuara për rritje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Kjo do të ndihmojë në fuqizimin e lidhjeve ndërmjet industrive, krijimin e ndërmarrjeve të reja të mbështetura nga ato ekzistuese dhe inovacionin nëpërmjet ndërlidhjes së tyre me përpjekjet e hulumtimit. Një biznes do të prodhojë apo ofrojë një shërbim të ri në bazë të informacioneve që do të marrë si rezultat i këtij grupimi. Vëmendje e veçantë në SKZH i kushtohet lidhje së sektorit të arsimit me ndërmarrjet nëpërmjet hulumtimit dhe zhvillimit (K&ZH) të produktit.

Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat. Fuqizimi dhe zhvillimi i sektorit të NVM-së, me fokus të veçantë në inovacion, është prioritet i politikave të qeverisë së Kosovës. Kjo në veçanti pasqyrohet në dy dokumente paraprake që kanë mbuluar pjesërisht çështje të ndërmarrësisë dhe më pak inovacionin: “Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017” dhe “Strategjia e Zhvillimit të NVM-ve 2012-2016”. Të dy dokumentet kanë skaduar dhe duhet të vazhdojnë. Strategjia për NVM-të ka për qëllim krijimin e mjedisit biznesor të favorshëm për NVM, promovimin e kulturës ndërmarrëse dhe rritjen e konkurrueshmërisë (ndërkombëtare) të NVM-ve. Është duke u zbatuar një projekt për të realizuar një version të përditësuar të Strategjisë për Zhvillimin e Sektorit Privat, i cili është autorizuar nga MTI. Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi është harmonizuar me orientimet dhe prioritetet kryesore të Strategjitë për ZHSP.

Programi për Reforma Ekonomike (2016-2018). Në PRE përcaktohet korniza e përgjithshme e politikave dhe objektivave për rritje ekonomike. Gjithashtu i kushtohet vëmendje e veçantë hulumtimit dhe inovacionit për mbështetjen e rritjes afatgjate. Në PRE gjithashtu njihet që mbështetja për fushën e hulumtimit dhe inovacionit në Kosovë është e ulët, me buxhetin për shkencë dhe hulumtim që arrin vlerën prej rreth 0,1% të BPV. Në bazë të Ligjit për Veprimtarinë Shkencore – Hulumtuese, qeveria e Kosovës duhet të ndajë 0,7% të buxhetit vjetor. Në PRE theksohet që pengesa kryesore strukturore për hulumtim dhe inovacion është mungesa e kornizës ligjore dhe e politikave për mbështetjen e R&D. Aktualisht nuk ka legjislacion relevant për hulumtim dhe zhvillim (R&D) ose akte nënligjore që rregullojnë fushën e inovacionit dhe transferimit të teknologjisë dhe njohurive. Në aspektin e politikave, nuk ka lirime nga tatimi për veprimtarinë e R&D e as grante publike që janë ndarë në mënyrë specifike për ndërmarrjet për qëllime të R&D. Dobësitë e identifikuar në PRE janë adresuar me strategjinë aktuale për inovacion dhe ndërmarrësi dhe përpjekjet e vazhdueshme të MIN për hartimin e Ligjit për Ndërmarrësi dhe Inovacion.

Strategjia e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Kosovë. Strategjia e BERZH për Kosovën thekson sfidat kryesore për rritjen ekonomike të Kosovës. Në fushën e zhvillimit të sektorit privat, në strategji sugjerohet se për zhvillim të qëndrueshëm duhet të bëhen përmirësime të mëdha në fushat e fuqizimit të klimës investuese, ndërtimit të qeverisjes dhe sundimit të ligjit dhe fuqizimit të konkurrueshmërisë së ekonomisë. Kjo e fundit është adresuar në Strategjinë për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Sipas BERZH (2018), prodhimi me vlerë të shtuar pengohet nga kapaciteti i kufizuar i brendshëm, teknologjia e vjetërsuar, mjedisi i vështirë biznesor dhe qasja e kufizuar në financa. Prandaj, prioritet i është dhënë fuqizimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat nëpërmjet përfitimit të efikasitetit, miratimit të praktikave inovative operative, praktikave të përmirësuar menaxheriale, mjedisit të përmirësuar biznesor dhe qasjes në financa.

Programi Kombëtar për Huluntim, i hartuar nga MASHT dhe miratuar nga QK në vitin 2010, ka për qëllim ofrimin e kornizës konceptuale për përmirësimin e kapaciteteve shkencore në Kosovë. Objektivat specifik janë: i) Ngritja e kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë huluntuuese; ii) Zhvillimi i infrastrukturës huluntuuese; iii) Ndërkombëtarëzimi i veprimtarisë huluntuuese-shkencore; iv) Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për përmirësimin e zhvillimit ekonomik dhe social; dhe v) Përsosmëri në veprimtarinë huluntuuese dhe shkencore.

Strategjia për TI. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është promovimi i zhvillimit të industrisë së TI-së në Kosovë për të arritur qëllimin e përgjithshëm, i cili përcaktohet si: *Industria e TI-së do të bëhet shtytësi kryesor për rritje ekonomike, punësim dhe inovacion deri në vitin 2020 përmes rritjes së konkurrueshmërisë ndërkombëtare të industrisë së TI-së në Kosovë të bazuar në ekselencë digjitale*⁷. Përfituesi kryesor dhe grupi i synuar i strategjisë është industria e TI-së në Kosovë. Temat e ndërlidhura si infrastruktura e TI-së dhe e-qeverisja janë mbuluar nga strategji tjera. Ideja kryesore e strategjisë së Kosovës për TI është që forcimi i sektorit të TI-së në Kosovë është detyrë mjaftë e ndërlikuar, andaj kërkon qasje të përbashkët që i përfshinë të gjithë akterët relevant, si kompanitë e TI-së, shoqatat, ministritë, universitetet dhe donatorët. Strategjia aktuale për Inovacion dhe Ndërmarrësi është e harmonizuar mirë me Strategjinë e Kosovës për TI. Fusha Strategjike 7 (Ndërmarrësia) dhe 8 (Inovacioni dhe R&D) adresojnë objektiva të ngjashëm. Gjatë zbatimit të të dyja strategjive i është kushtuar vëmendje arritjes së sinergjive dhe shmangies së veprimeve të tepërta. Këshilli Kombëtar Këshillues për Inovacion dhe Ndërmarrësi është përgjegjës për koordinimin e masave të ndërlidhura, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë për Inovacion dhe Ndërmarrësi.

Për më tepër, duhet të sigurohet harmonizim i fuqishëm me qasjen e **Strategjisë për Specializim të Mençur**, e cila pritet të ketë rëndësi më të madhe në Kosovë. Rritja e mençur është shtylla kryesore e Strategjisë së EJKL për 2020. Bazohet në idenë që rritja duhet të shtyhet nga përdorimi më i mirë i teknologjive bashkëkohore që mbështesin prodhimin dhe shërbimet me kualifikim të lartë dhe vlerë të lartë të shtuar në vend të prodhimit me vlerë të ulët të shtuar dhe kosto të ulëta. Me fjalë tjera, ka për qëllim zhvillimin e ekonomive të bazuar në njohuri. Blloqet ndërtuese të nevojshme për rritje të mençur përfshijnë investimin në infrastruktura të huluntimit dhe inovacionit, njohurisë dhe informacionit dhe një marrëdhënie të ngushtë ndërmjet universiteteve dhe sektorit të biznesit. Strategjitë për Specializim të Mençur (S3), një koncept i ri i zhvilluar nga Komisioni Evropian, ofron një element të rritjes së mençur. Specializimi i mençur është politikë ekonomike e integruar e bazuar në vend (Foray et al., 2012). Gur themeli për qasjen e specializimit të mençur është identifikimi i nevojës që rajonet apo kombet të shndërrojnë burimet në fusha kryesore me potencial të lartë ekonomik në sektorë, rajone apo niche të caktuara të tregut (Bartlett et al. 2018). Kërkon transformimin e bazës së njohurive, teknologjisë dhe burimeve tjera plotësuese për integrim në rrjetet e prodhimit dhe zinxhirët global të vlerave (Radosevic & Stancova, 2018; Georghiou et al., 2014). Specializimi i mençur mbështetë masat për integrimin e NVM-ve në zinxhirin e vlerës së inovacionit. Fokusi kryesor është në identifikimin e strategjive rajonale “të mençura” të cilat do të mund të mundësonin specializimin në fushat që inkurajojnë plotësime me aftësitë prodhuese të një rajoni.

Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi përfshinë elementet kryesore dhe filozofitë e qasjes së S3, të përshtatura me sfidat aktuale në Kosovë. Në këtë mënyrë, Strategjia aktuale për Inovacion dhe Ndërmarrësi mund të kuptohet si një qasje duke stimuluar specializimin në fusha të caktuara,

⁷ Strategjia e Kosovës për TI, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_IT_Strategy.pdf, qasur më 28 nëntor 2018

ku sektori publik dhe privat ka fituar përparësi të konsiderueshme, si në TIK dhe vlerë të lartë të shtuar. Strategjia aktuale do të veprojë si ombrellë për konkurrueshmërinë afatgjate dhe inovacionin e sektorit privat, i cili mund të përdoret për zhvillimin e S3 në Kosovë.

Agjenda digjitale si pjesë e Strategjisë së Ballkanit Perëndimor dhe strategjitë tjera specifike për sektorin

Kosova është vend pjesëmarrës në bashkëpunimin rajonal ekonomik të Ballkanit Perëndimor. BP ka miratuar Planin Shumëvjeçar të Veprimit⁸ sipas të cilit agjenda digjitale është njëra nga tri shtyllat kryesore. MAP përcakton që përdorimi i teknologjive digjitale mund të gjenerojë përfitime të mëdha në aspektin e zhvillimit makroekonomik, si dhe shpejtësi, efikasitet dhe transparencë të aktiviteteve ekonomike përtej kufijve. Integrimi digjital përmirëson furnizimin e shërbimeve të reja tek konsumatorët dhe bizneset dhe mbështet zhvillimin socio-ekonomik, krijimin e vendeve të punës me vlerë të lartë dhe shoqërinë e bazuar në njohuri. Objektivi i veprimeve të ndërlidhura me agjendën digjitale të MAP është integrimi i rajonit në tregun digjital pan-Evropian në bazë të strategjisë afatgjate të digjitalizimit, mjedisit të përditësuar rregullativ, infrastrukturës së përmirësuar broadband (brezëgjërë) dhe qasjes dhe njohurive digjitale.

Kosova ka shënuar progres të mirë në këtë fushë dhe planifikon krijimin e Atlasit Elektronik për Infrastrukturë të Telekomunikimeve Broadband. Me mbështetjen e Bankës Botërore janë realizuar dy studime: Lehtësimi i Ndarjes Efikase të Infrastrukturës për Kosovën * dhe programi Broadband për Zona Rurale. Kosova* gjithashtu ka siguruar një kredi nga Banka Botërore në vlerë prej 20 milionë € për zhvillimin e infrastrukturës broadband në zonat rurale dhe të pambuluara.⁹

⁸ MAP STOCKTAKING AND NEEDS ASSESSMENT REPORT (në dispozicion në https://www.rcc.int/priority_areas/39/map-rea), qasur më 25 nëntor 2018

⁹ Programi për Ekonominë Digjitale të Kosovës* (KODE)

3. Kushtet Kornizë për Inovacion dhe Ndërmarrësi

3.1 Hyrje

Gjatë analizimit të politikës së përgjithshme të Kosovës për inovacion dhe ndërmarrësi, vlen të përmendet se nuk ka pasur politikë kombëtare eksplicite dhe të koordinuar për ndërmarrësinë. Themelimi i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka gjasë të prodhojë përpjekje të fokusuara për nxitjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Ky seksion ofron një përmbledhje të kushteve kornizë të ekosistemit të ndërmarrësisë dhe inovacionit (Figura 2). Politika e inovacionit dhe ndërmarrësisë duhet t'i fokusojë përpjekjet e akterëve të ndryshëm në sektorin publik, si dhe donatorëve ndërkombëtarë, OJQ-ve dhe akterëve tjerë dhe të sigurojë koherencë në zbatimin e tyre.




Figura 2: Sistemi Kosovar i Inovacionit

Mjedisi makroekonomik

Kosova është vend me të ardhura të ulëta-të mesme, i cili ka shënuar rritje të qëndrueshme ekonomike gjatë dekadës së fundit. Kosova është një nga katër vendet në Evropë që shënon rritje çdo vit që nga fillimi i krizës financiare globale në vitin 2008 (Banka Botërore, 2018). Në vitin 2017, ekonomia e Kosovës u rrit në rreth 4.4% në krahasim me 4.1% nga viti 2016. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore për vitin 2018, ekonomia e Kosovës pritet të rritet me 4.85%, apo 0.6 pikë përqind më lartë se sa parashikimi i bërë në qershor të vitit 2017. Trendët pozitive ekonomike në aspektin e rritjes ekonomike priten edhe në vitin 2019. Sipas BB, BPV në Kosovë

parashihet të rritet në 4.8%, me një rënie të lehtë në 4.7% në vitin 2020 (Raporti i Pasqyrës Ekonomike Globale për vitin 2018). ASK raporton që BPV me çmimet aktuale në vitin 2017 ishte 6,413.8 milionë Euro, me rritje reale të BPV prej 4.23% në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016. BPV për kokë banori në Kosovë për vitin 2017 ishte 3,566 Euro.

Rritja e veprimtarisë ekonomike në Kosovë në vitin 2017 ishte mbështetur nga rritja e investimeve dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve.¹⁰ Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (2018), kontributi kryesor në rritjen reale të BPV është dhënë nga aktivitetet e ndërtimore, tregtare, financiare dhe të sigurimit, së bashku me industrinë përpunuese. Kjo është në harmoni me raportin e Bankës Botërore (2018)¹¹ i cili sugjeron që rishtazi ka pasur një zhvendosje të dukshme drejt rritjes së shtyrë më shumë nga investimet dhe eksporti.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK, 2018)¹² publikon të dhëna vjetore mbi BPV për vitin 2017 sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve bazuar në ESA 2010. Është interesante të theksohet që norma e rritjes reale në BPV sipas aktiviteteve ekonomike për vitin 2017 ishte si në vijim: aktivitetet financiare dhe të sigurimit 31.4%, ndërtimtaria 8.6%, tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave 4.5%, informimi dhe komunikimi 3.4%, industria nxjerrëse 3.1%, prodhimtaria 3.0%, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike 2.8%, transporti dhe magazinimi 2.8%, bujqësia, pylltaria dhe peshkataria 2.7%, afarizmi me pasuri të patundshme 2.6%, furnizimi me energji elektrike, me gaz 2.5%, aktivitetet administrative dhe mbështetëse 2.5%, hotelet dhe restorantet 2.4%, art, zbavitje dhe rekreacion 1.9%, shërbime tjera 1.2%, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale 1.1%, furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e rehabilitimit 1.1%, administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social 0.9%.

Edhe pse rritja e ekonomike e Kosovës ka tejkaluar fqinjët e saj dhe ka qenë kryesisht gjithëpërfshirëse, kjo nuk ka mjaftuar për zvogëlimin e konsiderueshëm të normave të larta të papunësisë; ofrimin e vendeve formale të punës, në veçanti për gratë dhe të rinjtë; apo ndryshimin e trendit të migrimit në shkallë të madhe. Edhe pse ka pasur rënie të konsiderueshme në shkallën e papunësisë, ajo prapë mbetet e lartë. Norma e papunësisë në vitin 2014 ishte 35,3% dhe në vitin 2017 ishte 30,5%. Paga mesatare në sektorin publik është më e lartë në krahasim me sektorin privat. Paga mesatare neto në sektorin publik në vitin 2016 ishte 449 € ndërsa në sektorin privat ishte 359€. Sektori privat në Kosovë ka gjeneruar 145,736 vende të punës në vitin 2014 (ASK, 2017). Modeli i rritjes mbështetet kryesisht në remitencë për konsumin vendor. Fluksi hyrës i remitencave në vitin 2014 ishte 622.3 milionë €, ndërsa në vitin 2017 ishte 759.2 milionë € (Banka Qendrore e Kosovës).

Në tregtinë ndërkombëtare, të dhënat nga Tregtia e Huaj e Kosovës tregojnë një deficit më të ulët tregtar prej 3.1% në prill të vitit 2017, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Kjo shifër është rreth 220.6 milion € në krahasim me deficitin prej 227,6 milion € në vitin 2016. Eksportet mbulojnë importet gjatë kësaj periudhe (12.4%). Eksportet e mallrave në prill të vitit 2017 arritën vlerën prej 31.2 milion €, ndërsa importi 251.8 milion €, që paraqet një rritje të eksporteve (35.5%) dhe importeve (me 0.5%) në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Sipas të dhënave të grupeve kryesore eksportuese: (37.5%) e eksporteve përbëhen nga metalet bazë dhe artikujt e tyre, (21.7%) produktet minerale, (9.2%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (8.4%)

¹⁰ https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2017/CBK_Q4_2017.pdf (qasur më 26 nëntor 2018)

¹¹ <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview> (qasur më 25 nëntor 2018)

¹² <http://ask.rks-gov.net/media/4333/gross-domestic-product-gdp-production-approach-2017.pdf> (qasur më 21 nëntor)

ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (4.4%) produktet bimore, (3.2%) lëkurë dhe artikuj prej tyre. Në veçanti ka rritje të eksportit të kategorisë së shërbimeve si përqindje në BPV nga 10.1 përqind në vitin 2008 në 23.9 përqind në vitin 2017 (ASK, 2018). Këto shifra mund të sugjerojnë potencial të lartë për konkurrueshmërinë e sektorit privat.

Në aspektin e aktivitetit afarist, ka pasur rritje të konsiderueshme në numrin e ndërmarrjeve. Numri i bizneseve të regjistruara që konsiderohen aktive në vitin 2015 ishte 142.299 biznese, në vitin 2017 ishte 161.946 biznese (Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë). Megjithatë, numri i bizneseve aktive që kanë qenë tatimpagues aktiv ishte shumë më i ulët. Numri i bizneseve aktive në vitin 2017 ishte 62.567 biznese. Këto biznese kanë deklaruar formularët e deklaratave në Administratën Tatimore të Kosovës me vlera zero (Administrata Tatimore e Kosovës, 2018). Kjo tregon aktivitet të lartë joformal të firmave në Kosovë, rreth 38%. Kjo është e ngjashme me të gjeturën në bazë të anketës së bizneseve që sugjeron shitje të pa-raportuara të sektorit të biznesit prej 35.7 përqind të shitjeve (Williams dhe Krasniqi, 2018).

Sa i përket llojit të pronësisë së biznesit, shumica e bizneseve janë të organizuara si ndërmarrje individuale. Sipas Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve (ARB) në vitin 2016, 85% e ndërmarrjeve ishin regjistruar si individuale. Në bazë të të dhënave nga burimet e njëjta, ekziston një ndryshim i konsiderueshëm në aspektin e formatit ligjor të bizneseve në vitet e fundit. Kemi një rënie në numrin e bizneseve individuale, ndërsa rritje në partneritetet biznesore dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Në krahasim me vitin 2003, numri i kompanive në pronësi të huaj ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej 0.5%, duke sugjeruar një rol më aktiv të kompanive të huaja në Kosovë. Një tjetër veçori e sektorit privat të Kosovës është dominimi i firmave në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve në krahasim me sektorët tjerë, veçanërisht prodhimin. Numri i kompanive prodhuese ka mbetur shumë i ulët që nga viti 2000, me rritje të ngadalshme në vitet e fundit. Edhe pse rritja e ngadalshme, përqindja e kompanive prodhuese është rritur nga 4.9% në vitin 2008 në 6.35% në vitin 2014, që tregon një përmirësim në aspektin e sektorit të prodhimit.

3.2 Gjendja aktuale në inovacion dhe ndërmarrësi

Inovacioni në mesin e NVM-ve në Kosovë duket të jetë minimal, ku shumica e bizneseve në zhvillim zhvillohen përmes përdorimit të modeleve ekzistuese.¹³ Ndërkohë që ka progres me të dhënat për aktivitetet e ndërmarrësisë, ende ka mungesë të statistikave për inovacionin në Kosovë për të vlerësuar kapacitetet dhe angazhimin e NVM-ve në inovacion. Një nga anketat më të fundit të realizuara për këtë qëllim është anketa e sektorit privat me 153 kompani, e zbatuar nga OECD në vitin 2013 për të vlerësuar sistemin e inovacionit në Kosovë.¹⁴ OECD raporton se shumë firma konsideruan veten të jenë inovative, me nivele të larta të bashkëpunimeve në inovacion, por koncepti i inovacionit kuptohet gjerësisht dhe i referohet kryesisht inovacionit gradual ose të vogël që i përgjigjet përshtatjes ose futjes në treg. Në të vërtetë, vetëm disa firma janë realisht të angazhuara në aktivitete të R&D (hulumtimit dhe zhvillimit) - rreth 80% e këtyre firmave nuk kryejnë realisht aktivitete formale për R&D, dhe 77 për qind kanë investuar më pak se 1000 euro në R&D gjatë periudhës 2009-2011. 62 për qind e kompanive të anketuara që

¹³ http://www.eib.org/attachments/efs/assessment_of_financing_needs_of_smes_kosovo_en.pdf, qasur më 1 dhjetor, 2018

¹⁴ OECD (2013) Vlerësimi i Sistemit Inovativ të Kosovës*, <https://www.oecd.org/south-east-europe/programme/Kosovo%20Innovation%20Report%20English%20Version.pdf>, qasur më 28 nëntor 2018

perceptojnë veten si inovative nuk kanë kushtuar ndonjë burim financiar për R&D gjatë periudhës 2009-2011. Gjetje të ngjashme janë raportuar nga Qendra Kosovare për Përkrahje të Biznesit (2013) ku vetëm 13.2 për qind e NVM kanë deklaruar se gjatë tri viteve të fundit kompania ka ndërmarrë aktivitete të R&D për krijimin ose modifikimin substancial të produkteve, shërbimeve ose proceseve të reja.¹⁵

Ekzistojnë disa pengesa që pengojnë ndërmarrësinë dhe kryesisht performancën e inovacionit në Kosovë. Disa nga këto pengesa mund të jenë gjenerike dhe të lidhura me mjedisin e përgjithshëm të biznesit ndërsa disa të tjera janë më specifike për firmën dhe sektorin. Sipas Bankës Evropiane për Investime - EIB (2016), Raporti i Vendit për Kosovën 2016 (Vlerësimi i nevojave financiare të NVM-ve në Kosovë) identifikoi që mikro-firmat përballen me boshllëqe financiare si huat dhe financa të ekuitetit. Edhe pse financimi për NVM është i disponueshëm, kërkesat e larta të kolateralit paraqesin një pengesë të madhe për qasje në financa. Bankat nuk financojnë startup-et deri në 6-12 muaj dhe bankat e mëdha së fundmi kanë vendosur të ndërpresin shërbimin ndaj segmentit të mikro-ndërmarrjeve, mikro-huat tani kryesisht ofrohen nga sektori i vogël i mikrofinancave (IMF-të). Ndërkohë që bankat kanë likuiditet të lartë për shkak të nivelit të lartë të financimit të depozitave, institucionet mikrofinanciare përpiqen të plotësojnë kërkesën në rritje për shkak të burimeve të kufizuara të financimit. Kosto e fondeve për IMF-të nga mjetet e investimit mikrofinanciar dhe burimet tjera arrin në 6-8%, që është ekuivalente (on par) me normat e ofruara aktualisht tek huamarrësit nga bankat. Financat e ndërmarrjeve start-up janë edhe më të kufizuara, me shumicën e huadhënësve që kërkojnë pasqyra financiare për të paktën gjashtë muaj për t'u kualifikuar për hua.

Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën për vitin 2016 (BE 2016), gjithashtu thekson se pengesat kryesore për zhvillim dhe rritjen e mëtejme të NVM-ve mbeten qasja e kufizuar në financa, zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregulloreve të biznesit, barrierat administrative, konkurrenca jo e drejtë nga sektori joformal, një gjyqësor joefikas dhe korrupsioni. Raporti i BE-së për vitin 2016 thekson se është bërë pak progres në këtë fushë, sidomos me krijimin e një KCBS.

Një mjet tjetër i rëndësishëm i politikave të NVM-ve është Akti i BE-së për Biznese të Vogla, që është një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe BE-së për t'i ndihmuar Kosovës të shtrojë rrugën e saj të ardhshme për në BE. Siç u rekomandua vitin e kaluar, Kosova në veçanti duhet: të ndjekë rekomandimet nga vlerësimi i 'Aktit për Biznese të Vogla' të BE-së dhe të futë vlerësimet e ndikimit rregullativ për të reduktuar barrën administrative për NVM-të. Sipas indeksit të politikave të SBA të vitit 2016 (OECD/BE/BERZH/ETF/SEECEL 2016), NVM-të do të mund të përfitonin nga përkrahja e synuar për t'i ndihmuar ato që t'i qasen financave pa e shtrembëruar tregun, veçanërisht tani që disponueshmëria e kreditit është kaq e kufizuar në shumë ekonomi (Tabela 1). Kosova ka renditjen më të ulët në aspektin e renditjes për qasje në financa për NVM-të në Ballkanin Perëndimor. Ekziston nevoja për mbështetje të NVM-ve përmes alternativave të financimit jo-bankar duke i reformuar kornizat e tyre ligjore për të reduktuar pasigurinë ligjore që rrethon përdorimin e instrumenteve të tilla si faktoringu. Futja e vlerësimeve dhe programeve të edukimit financiar do të mund të përmirësonte po ashtu qasjen në burime të jashtme të financimit për periudha afat-mesme deri ato afat-gjata.

Tabela 1. Progresi në Dimensionin 6: Qasja në financa për NVM-të

	WBT
--	------------

¹⁵ <http://www.bsckosovo.org/publikimet/20140205055101250.pdf> (qasur më 30 nëntor 2018)

Dimensioni 6	ALB	BIH	KOS	MKD	MNE	SRB	TUR	mesatarja
<i>2016 mesatarja</i>	3.26	3.25	3.21	3.46	3.25	3.62	3.89	3.42
<i>2012 mesatarja</i>	3.04	3.09	2.17	2.96	3.07	3.83	3.72	3.13

Shënim: Ndryshime thelbësore metodologjike në Dimensionin 6 nuk lejojnë krahasim të drejtpërdrejtë midis rezultateve të vitit 2016 dhe 2012.

Kosova ka renditjen më të ulët në mesin e vendeve homologe për shërbimet përkrahëse për NVM-të dhe startup-et në Indeksin e Politikave të NVM-ve për vitin 2016. Për më tepër, situata nuk është përmirësuar pothuajse fare që nga viti 2014. Zhvillimi i kornizave të politikave për të vendosur ndërmarrësinë në qendër të rritjes dhe krijimit të vendeve të punës do të mund të përfitonte shumë nga krijimi i partneriteteve të vërteta midis shtetit dhe komunitetit të biznesit. Në përputhje me politikat e BE-së, ndërmarrësia do të mund të ishte një levë kyçe për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë (e cila është 61% në mesin e moshave 15-24 vjeç) dhe papunësinë tek femrat (41.6% në vitin 2014).

Vlerësimi i nevojave financiare të NVM-ve në Ballkanin Perëndimor vë në pah rëndësinë e inovacionit dhe rolin e tij në sigurimin e kapacitetit absorbues të NVM-ve. Edhe pse është duke u zhvilluar infrastruktura e nevojshme, qëndrueshmëria e saj financiare dhe kapaciteti këshillues duhet të përmirësohen. Së fundi, duhet të zhvillohen instrumentet financiare të dedikuara për të nxitur qasjen e NVM-ve në financa, për të nxitur bizneset të bashkëpunojnë me institucionet.

Në fushën e Hulumtimit dhe Inovacionit, Programi për Reforma Ekonomike 2017-2019 (PRE) thekson që kapaciteti i Kosovës për hulumtime, zhvillim dhe inovacion (RDI) është shumë i ulët, kjo kufizon krijimin e vendeve të reja të punës. PRE (QK 2016) njeh dhe thekson mungesën e një kornize ligjore dhe të politikave si dhe nivelin e ulët të përkushtimit politik ndaj RDI, që reflektohet në shpenzime shumë të ulëta publike (0.1% e BPV-së). Analiza po ashtu lajmëron në mënyrë adekuate mungesën e stimujve për sektorin privat dhe akademinë, edhe pse nuk ka referencë për kapacitetin e ulët absorbues të kompanive dhe kapacitetin e kufizuar të universiteteve për hulumtime të specializuara dhe mungesën e rezultateve në komercializim. Masa për të përmirësuar kornizën strategjike dhe atë të politikave është e re por ndikimi i pritur mund të mos arrihet nëse masa nuk plotësohet nga veprime më ambicioze për të ndihmuar dhe shtytur aktivitetet e zbatuara hulumtuese në Arsimin e Lartë, dhe për të përmirësuar në menyre të konsiderueshme bashkëpunimin ndërmjet institucioneve hulumtuese dhe sektorit privat. Infrastruktura e vetme shkencore e vendit janë laboratorët e institucioneve hulumtuese shkencore. Universitetet nuk kanë aktivitete për krijimin e inkubatorëve, startup-eve etj.

Ngritja e kapaciteteve të inovacionit të NVM-ve ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në aspektin e shërbimeve të tjera përkrahëse për të zhvilluar bazën e aftësive të NVM-ve dhe startup-eve. Edhe pse Kosova ka bërë pak progres sipas Indeksit të Politikave të SBA të vitit 2016, i nevojitet të bëjë një përpjekje më të qëndrueshme për të ndërtuar njohuritë dhe aftësitë në mesin e NVM-ve që dëshirojnë të tregtojnë me BE-në. Duhet të zhvillohet edhe garantimi i cilësisë së arsimit dhe aftësimit profesional. Hapat themelorë duhet të jenë zhvillimi dhe miratimi i kornizave të politikave (plotësimi i kornizës ligjore për inovacion dhe ndërmarrësi, përditësimi i Strategjisë për Zhvillimin e NVM-vë dhe Strategjisë për Mësimin Ndërmarrës), shoqëruar nga një zhvillim i mëtejshëm i infrastrukturës që lidhet me inovacionin dhe instrumenteve financiare që mbulon tërë ciklin financiar nga fillimi (start-up) deri tek fazat e rritjes së madhe të NVM-ve. Këto veprime duhet të marrin në konsideratë "ekosistemin" ekzistues të inovacionit dhe të inkurajojnë më shumë bashkëpunimin ndërmjet akademisë dhe sektorit privat, dhe rritjen e ndërgjegjësimit për inovacionin në mesin e publikut të gjerë dhe veçanërisht rinisë.

Në përgjithësi, ka ende mungesë së instrumenteve financiare që promovojnë inovacionin brenda NVM-ve. Skemat vauçer të inovacionit, skemat e garancive kreditore dhe programet për të promovuar lidhjet ndërmjet biznesit dhe akademisë duhet të vihen më gjerësisht në dispozicion në tërë Kosovën. Rekomandimi kyç vendimtar për këtë raport dhe IPA të ardhshëm është ndërtimi i inteligjencës mbi aftësitë e NVM-ve dhe nevojat për të krijuar një pikë të vetme informacioni në trajnimin e biznesit të ofruar për ndërmarrësit. Lidhja e inovacionit me akademinë dhe sektorin privat dhe zgjerimi i ofrimit të trajnimit dhe mentorimit për ndërmarrësit e rinj dhe ndërmarrëset femra.

Rritja dinamike e sektorit të ri privat ka qenë një prej forcave kyçe nxitëse prapa rimëkëmbjes ekonomike në të gjitha vendet ish-komuniste. Kosova nuk bën përjashtim. Përkundër rëndësisë, mjedisi i biznesit nuk ka qenë shumë i favorshëm për NVM-të. Hallberg (2000) argumenton se mjedisi i qëndrueshëm dhe inkurajues i biznesit është një parakusht kyç për suksesin e çdo përkrahje të synuar të politikave.

Kosova ka përmirësuar ndjeshëm rregulloret e veta të biznesit siç është konstatuar nga Treguesit e të Bërit Biznes në vitin 2017 (Banka Botërore 2017). Kosova është duke zbatuar reformat për të ngushtuar boshllëkun me kufirin rregullator global (Banka Botërore, 2017). Raporti i të bërit Biznes për vitin 2017 konstaton se Kosova e lehtësoi pagesën e tatimeve me futjen e një sistemi online për depozitim dhe pagesën e TVSH-së dhe kontributeve të sigurimeve sociale. Sot, pagesa e tatimeve është më pak e kushtueshme duke lejuar më shumë lloje të shpenzimeve të zbriten për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat e korporatave. Përveç kësaj, Kosova po ashtu lehtësoi tregtimin ndërkufitar duke e reduktuar kohën dhe koston e përputhshmërisë dokumentare dhe kohën e përputhshmërisë kufitare për eksport duke përmirësuar sistemin e saj të automatizuar të menaxhimit të të dhënave doganore, duke riorganizuar proceset e zhdoganimit dhe duke zbatuar Korridorin Transit Shqipëri-Kosovë.

Raportet e progresit të BE-së gjithashtu tregojnë nevojën për intervenime të ardhshme. Sipas raportit të Progresit të BE-së (2016, f.41) nuk ka pasur progres në adresimin e dobësive strukturore të sektorit privat të Kosovës, i cili vazhdon të jetë i fragmentuar dhe i paaftë për të përmirësuar efikasitetin e tij. Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme strukturore në ekonominë e Kosovës që nga viti 2008. Raporti i BE-së sugjeron që struktura e sektorëve ekonomikë ende nuk është e favorshme, ndërsa sektori i bujqësisë që kontribuon me 13.5% të vlerës së shtuar bruto (VSHB) (krahasuar me 17.5% në vitin 2008), është përgjegjës për 26.7% të totalit të punësimit dhe siguron rreth 12% të vlerës totale të mallrave të eksportuara. Shenja premtuese është rritja e sektorit të shërbimeve në 59% të VSHB-së (krahasuar me 55% në vitin 2008), përqendruar në sektorin e tregtisë, financave dhe TI-së. Përveç kësaj shenje pozitive, krahasuar me mesataren e vendeve të zhvilluara, ekonomia e Kosovës është ende e prapambetur sa i përket diversifikimit të sektorit. NVM-të vazhdojnë të përbëjnë 99% të totalit të punësimit. Numri më i madh i ndërmarrjeve operojnë në sektorin e tregtisë (29.9%), ndjekur nga akomodimi, shërbimet ushqimore dhe industria.

Të Drejtat e Pronësisë Intellektuale

Regjistrimi i pronës intelektuale bazohet në praktikat rajonale dhe ndërkombëtare. Procesi i regjistrimit të markës tregtare zgjat përafërsisht nëntë muaj, ndërsa patentat zgjasin rreth 18 muaj. Ndërgjegjësimi i publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së brendit dhe përkatësisht DPI është i ulët. Një numër mallrash të falsifikuara të konsumit, sidomos CD-të, DVD-të dhe artikujt e veshmbathjes janë në dispozicion për shitje dhe tregtohen haptazi. Qeveria gjurmon dhe raporton

për sekuestrimet e mallrave të falsifikuara. Në vitin 2016, Dogana konfiskoi mallra të falsifikuara në vlerë mbi 2.5 milionë euro, gjë që sugjeron një përmirësim në përpjekjet e qeverisë për të zbatuar DPI-në.¹⁶

Dëshmitë sugjerojnë se ka pak prodhim vendor të mallrave të falsifikuara në Kosovë, por importimi i mallrave të falsifikuara, veçanërisht i veshmbathjeve, është një shqetësim. Mbrojtjet e DPI janë duke u përmirësuar ngadalë, kufizuar nga një mungesë e vazhdueshme e ndërgjegjësimit në mesin e sistemit publik dhe gjyqësor. Ligji për Patenta, Ligji për Markat Tregtare, Ligji për Dizajnin Industrial dhe Ligji për Treguesit Gjeografik, së bashku me Kodin Penal përkatës dhe dispozitat doganore, parashohin mbrojtje të fortë të të drejtave të pronësisë intelektuale; autorizojnë zbatimin e ligjeve të markave tregtare, të të drejtave autoriale dhe të patentave; dhe përputhen me konventat përkatëse ndërkombëtare. Ligjet e DPI janë ndryshuar në vitin 2015 për të forcuar mjetet juridike për bartësit e të drejtave dhe për t'i harmonizuar ato më tej me standardet e BE-së.

MTI ka themeluar Zyrën për të Drejtat e Pronësisë Industriale (ZPI) në vitin 2007, e cila është e ngarkuar me mbrojtjen e DPI. Zyra e Pronësisë Industriale është një institucion që merret me veprimtarinë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale. Zyra zbaton procedurat për mbrojtjen dhe regjistrimin e të drejtave sipas Ligjit Nr. 2004/49 për Patentim, Ligjit Nr. 02/L-100 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2004/49 për Patentim dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 2007/06 për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Pronësisë Industriale. Megjithatë, niveli i ulët i inovacionit reflektohet në numrin e kufizuar të aplikacioneve të suksesshme për patentë. Në bazë të të dhënave të Departamentit për Shkencë dhe Teknologji të MASHT-it, numrin e punonjësve në R&D është vetëm 833, 3 punonjës në një milionë banorë (PRE, 2016). Sipas të dhënave tona aktuale, Zyra për Patenta në MTI ka miratuar 32 patenta që nga viti 2016, ndërsa Zyra Evropiane për Patenta nuk ka miratuar asnjë.

3.3 Programet aktuale të mbështetjes për inovacionin dhe ndërmarrësinë

Ky seksion ofron shpjegime mbi statusin aktual të skemave mbështetëse të cilat synojnë mbështetjen e bizneseve start-up, ndërmarrësisë dhe inovacionit në Kosovë. Përfshin një inventar të institucioneve/mbështetësve (ndërmjetësve të inovacionit) që ofrojnë mbështetje për ndërmarrësinë dhe inovacionin si dhe të skemave dhe programeve ekzistuese të mbështetjes. Bashkëveprimi ndërmjet ndërmjetësve të inovacionit dhe programeve mbështetëse është thelbësor për Kosovën. Detyra kryesore për ndërmjetësit e inovacionit është të promovojë dhe rrisë ndërgjegjësimin për inovacionin dhe trendët e reja teknike/të tregut, duke përfshirë krijimin e kureshtjes dhe duke kërkuar nga NVM-të që të jenë inovative. Programet e mbështetjes së inovacionit kryesisht hyjnë në lojë për të zvogëluar rrezikun e investimit për NVM-të duke siguruar qasje në burimet financiare. Për të pasur sukses në aspektin afatgjatë, skema kosovare e mbështetjes së inovacionit dhe ndërmarrësisë duhet të ofrojë tërë mbështetjen e nevojshme përgjatë zinxhirit të inovacionit (s. Fig. 3)

¹⁶ <https://www.export.gov/article?id=Kosovo-Protection-of-Property-Rights>, qasur më 15 nëntor 2018




Figura 3: Ndërveprimi midis mbështetjes institucionale dhe programatike të inovacionit

Ekosistemi i inovacionit në Kosovë ofron shumë iniciativa për bizneset start-up dhe mbështetjen e inovacionit, por ato fragmentohen dhe shumica prej tyre duket se nuk punojnë së bashku. Si të tilla, nuk mund të shfrytëzojnë komplementaritetet e mundshme ndërmjet projekteve dhe edhe më shumë përfitim nga sistemi më i integruar i mbështetjes. Për mbështetjen e financave, përdorimi i shpeshtë i formave tradicionale të financimit të bizneseve start-up, ndërkohë që llojet më moderne të financimit si VC (Kapitali Ndërmarrës) dhe crowdfunding (grumbullimi i fondeve nga masa) janë shumë të kufizuara. Ajo që pason është se secili lloj i instrumenteve do të diskutohet.

3.3.1 Skemat e mbështetjes programatike

Financat ndërmarrëse janë duke u zhvilluar shpejt në mbarë botën. Ndërmarrësit janë duke kombinuar borxhin tradicional dhe financat e ekuitetit të bizneseve start-up (p.sh. miqtë, familja, investitorët engjëj, kapitalistët e ndërmarrjeve, dhe nganjëherë bankat) me mënyra alternative të financimit (Bruton et al. 2015). Në fazën e saj fillestare të zhvillimit, Kosova ende nuk ka shfrytëzuar plotësisht përfitimet e të gjitha financave tradicionale të bizneseve start-up. Mbështetja financiare e bizneseve start-up është kufizuar kryesisht në ofrimin e granteve, pajisjeve dhe makinerive, grantet bashkëfinancuese, dhe në një masë më të vogël nga investitorët engjëj dhe financimi i ekuitetit si dhe fondet e kapitaleve ndërmarrëse pothuajse nuk ekzistojnë.¹⁷

Në anën tjetër, bizneset start-up dhe veçanërisht firmat e nxitura nga inovacioni me synime të orientuara drejt rritjes përballen me vështirësi në qasjen e financave për projekte të reja inovative. Rrjedhimisht, ekziston një domosdoshmëri për të gjetur një zgjidhje kreative për të mbushur këtë boshllëk të lidhur me qasjen në financa për bizneset start-up dhe NVM-të, për të cilat qasja në sistemin tradicional bankar ka qenë pothuajse e pamundur. Prandaj, është shumë e rëndësishme të ketë përpjekje të përqendruara të të gjithë akterëve, duke përfshirë por pa u kufizuar në, të gjitha institucionet dhe agjencitë qeveritare, komunitetin e biznesit, donatorët ndërkombëtarë për të shqyrtuar mundësinë për gjetjen e instrumenteve alternative të financimit për bizneset start-up. Skema të tilla alternative të financave që dëshmuar të jenë të suksesshme në konteste tjera dhe mund të bëhen më të qëndrueshme në aspektin afatgjatë (platformat crowdfunding, investitorët engjëj, kapitalistët ndërmarrës etj.) mund të bëhen potencial për financimin e ndërmarrësisë dhe inovacionit në Kosovë.

Grantet. Deri më tani, grantet janë përdorur gjerësisht si mekanizma për të trajtuar boshllëkun financiar për bizneset start-up dhe inovacionin në Kosovë. Zakonisht, skemat e grantit marrin

¹⁷ Për më shumë detaje MTI 2014. 'Start-up Businesses and Business Support Services for Start-ups in Kosovo.' (Bizneset Start-up dhe Shërbimet Mbështetëse të Biznesit për Startup-et në Kosovë) Prishtinë: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, qasar më 23 nëntor 2018

formën e skemës së grantit përputhës dhe të skemës së grantit konkurrues të kombinuar me disa lloje të konkurseve të planit të biznesit dhe bashkëfinancimit nga ndërmarrësit (shih Shtojcën për detaje). Programet/projektet synojnë të tërheqin njerëz të talentuar me ide ndikuese të biznesit. Disa grante përdorën bashkëfinancim nga ndërmarrësit vendorë për të përfshirë ndërmarrësin në ndarjen e rrezikut për projekte ndërsa disa nga to u përdorën direkt për mbulim të plotë për të siguruar kapitalin fillestar pa ekuitet.

Huat. Përveç granteve, huat janë instrumenti primar i financimit për NVM-të, me shumicën dërrmuese të vëllimit të huave që vijnë nga bankat vendore. Huat më afatshkurtra të kapitalit punues janë më të famshmet, ndërsa huat e investimit shihen si më pak të kërkuara për shkak të kushteve të pasigurta politike dhe ekonomike. Edhe pse aktiviteti huadhënës është rritur kohëve të fundit në Kosovë, veçanërisht për huat e NVM-ve dhe veçanërisht gjatë vitit 2015, siç u theksua nga Banka Qendrore e Kosovës¹⁸ financat për bizneset start-up nga bankat vendore nuk janë të pranishme. Situata me ndërmarrëset femra është edhe më keq. Bankave të Kosovës u mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë, por vlerësojnë se NVM-të e udhëhequra nga gratë përfaqësojnë vetëm 0.5 - 5% të portfolios së tyre të huave¹⁹. Prandaj, sipas BERZH ka shpërndarje gjinore shumë të pabarabartë në fuqinë punëtore, 67% për burrat dhe 29% për gratë. Ndërmarrëset në Kosovë identifikojnë vetë pengesat kryesore si: qasja në financa (32% e të intervistuarve), këshilla ligjore (17%), mungesa e informacionit për praktikën e biznesit (14%), dhe vetëbesimi (11%). Ky program i mbështetjes financiare operohet në lidhje me mbështetje të tjera teknike.

Engjëjt e Biznesit dhe Kapitali Ndërmarrës. Investitorët engjëj janë zakonisht investitorët e ekuitetit në kompanitë start-up në fazën e hershme. Investitorët engjëj janë zakonisht individë të pasur që bashkohen në rrjetet e investitorëve që kërkojnë të gjejnë mundësi ndërmarrësie. Investimet nga engjëjt e biznesit mund të plotësojnë boshllëkun ndërmjet kapitalit ndërmarrës dhe financave të borxhit, veçanërisht për bizneset start-up. Deri para pak viteve, investitorët engjëj praktikisht nuk ekzistonin në Kosovë. Edhe pse rrjeti i investitorëve engjëj është duke u rritur në Kosovë, ende është në fazën fillestare të zhvillimit. Sot ka vetëm pak rrjete të engjëjve të biznesit si Rrjeti Kosovar i Biznes Engjëjve-KOSBAN, fondacioni MDA, gjirafa.com dhe disa investitorë engjëj individualë. Nuk ka dëshmi të qarta të rezultateve të arritura nga Rrjeti Kosovar i Biznes Engjëjve. Disa iniciativa të rrjeteve të biznes engjëjve që u përpoqën të mbijetojnë në punën e tyre nuk janë më duke funksionuar (p.sh. iniciativa EYE). Kultura e përgjithshme në promovimin e partneriteteve biznesore duhet të inkurajohet për të motivuar ndërmarrësit potencialë të bashkohen, duke përfshirë llojin e partneritetit të engjëjve të biznesit. Pavarësisht kësaj, engjëjt e biznesit mund të bëhen mënyrë premtuese e financimit të bizneseve start-up në Kosovë. Qeveria e Kosovës dhe mbështetja e donatorëve ka një rol të rëndësishëm për të luajtur. Për shembull, qeveria mund të ndihmojë në zhvillimin e një platforme interneti për të ofruar informacion për një listë investitorësh engjëj në Kosovë ose ata të interesuar për investime në projekte nga vendi. Ata po ashtu mund të mbështesin thirrjet e hapura për ide biznesi, eventet pitching (të grumbullimit të bizneseve start-up), B2B, të cilat më pas do të mund të lidheshin me rrjetin e engjëjve të biznesit në Kosovë dhe rajon. Kosova mund të mësojë nga shembulli i qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar (MB) që mbështet BAN-të dhe fushatat kombëtare duke theksuar rolin

¹⁸ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2015), *Raporti i Stabilitetit Financiar Numër 8*
<http://bqkkos.org/repository/docs/2015/Central%20Bank%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo-FSR.%20No.%208.pdf>

¹⁹ Shih <http://www.ebrd.com/womeninbusiness>, qasur më 22 nëntor 2018

dhe rëndësinë e engjëjve të biznesit (Kutia 1 në Shtojcë). Përveç kësaj, mund të përdoren forma të ndryshme të stimujve fiskal dhe jo-fiskal për të nxitur investime në bizneset start-up si në MB.²⁰

Fintech (Teknologjia financiare)/crowdfunding. Crowdfunding merr inspirim nga konceptet si mikrofinancat (Poetz dhe Schreier 2012, Morduch 1999) por përfaqëson një kategori unike të mbledhjes së fondeve, me mjete, procese dhe qëllime të ndryshme. (Mundial 2013). Crowdfunding vlerësohet të jetë një industri globale në rritje prej 5 miliardë dollarësh, është praktika e financimit të një projekti ose ndërmarrjeje duke mbledhur shuma të vogla të parave nga një numër i madh i individëve, zakonisht përmes internetit, duke përdorur një ndërmjetës si platformë (Forumi Ekonomik i Ballkanit, 2017)²¹. Ekzistojnë 2 lloje kryesore të crowdfunding: Crowdfunding me Ekuitet, kur ofruesit marrin aksione në një kompani. Në këtë proces, huamarrësit zakonisht aplikojnë online, zakonisht pa pagesë, dhe aplikacioni i tyre shqyrtohet dhe verifikohet nga softueri i platformës, i cili vlerëson edhe rrezikun e kredisë së huamarrësit dhe përcakton normën e interesit. Investitorët blejnë letra me vlerë, dhe nga ana tjetër, kjo lehtëson huat ndaj huamarrësve individualë. Investitorët bëjnë para nga interesi mbi huat e pasiguruara; platformat bëjnë para duke e ngarkuar një përqindje të huas dhe një tarifë për shërbimin e huas; dhe huamarrësi fiton qasje në kapital. Crowdfunding me shpërbllim - ku ndërmarrësit para-shesin një produkt ose shërbim para dërgimit për të lansuar një koncept biznesi pa shkaktuar borxhe ose pa sakrifikuar ekuitetin/aksionet. (Një lloj i tretë më pak i përdorur i crowdfunding janë paratë e zotuara si donacion. Crowdfunding ka dalë si mënyrë për t'i lejuar investitorëve individualë një mundësi që të grumbullojnë shuma relativisht të vogla të parave së bashku për të përmbushur kërkesat e financimit të ndërmarrjeve të reja ose atyre në zgjerim e sipër. Së fundi, rrjetet e ndryshme ekuivalente (peer-to-peer), borxhi dhe ekuiteti, përdorin rrjetet sociale për të shfrytëzuar komunitetet e ndërmarrësve dhe investitorëve në një përpjekje për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e grumbullimit dhe transferimit të fondeve.

Në Kosovë, ka një kërkesë në rritje për përdorimin e kësaj forme alternative të financimit si lloj më tradicional i financimit dhe Kosova mund të bazohet në shembuj të suksesshëm të vendeve tjera. Ekzistojnë disa parakushte për zhvillimin e platformave të crowdfunding, si:

- Disa platforma të crowdfunding janë më të suksesshme në grumbullimin e parave nga komunitetet e diasporës (komuniteti i madh i diasporës)
- Potenciali i TIK është i lartë në Kosovë
- Duhet të prezantohen sesionet dhe eventet informative për të promovuar parimet e crowdfunding tek startup-et, pronarët e bizneseve dhe investitorët
- Potenciali i madh në të ardhmen, për shkak se përshtatet me traditën tonë të ndihmës dhe bashkëpunimit të komunitetit.

3.3.2 Ndërmjetësuesit e inovacionit

Mbështetja për inovacionin dhe ndërmarrësinë mund të ofrohet edhe përmes institucioneve (ndërmjetësve), të ashtuquajtura mbështetja institucionale për inovacion. Një sistem kombëtar për inovacion ka nevojë për një shumëllojshmëri të gjerë të ndërmjetësve të ndryshëm, pasi të

²⁰ Për më shumë detaje mbi rrjetin e Engjujve të Biznesit në MB shih <http://www.angelcofund.co.uk/> , qasur më 2 dhjetor 2018

²¹ Për informata tjera vizitoni <http://www.balkaneconomicforum.org/wp/private-sector-investment-in-the-balkans/>

gjithë kanë kompetenca dhe role të ndryshme. Ndërmjetësit e tillë duhet të kenë detyra dhe role të qarta brenda një sistemi kombëtar të inovacionit. Për më tepër, ata duhet të jenë të pajisur siç duhet në aspektin e kapaciteteve njerëzore dhe burimeve financiare. Është shumë e rëndësishme që këta ndërmjetës të operojnë në mënyrë të koordinuar (qasja sistematike), mundësisht sipas mënyrave të ndryshme të "zinxhirit të inovacionit". Një vizatim skematik është dhënë në Figurën 4.

Infrastrukturës së mbështetjes së inovacionit në Kosovë i mungojnë përgjithësisht burimet institucionale dhe njerëzore dhe prandaj nuk është zhvilluar plotësisht deri më tani. Disa institucione janë krijuar për të mbështetur teknologjinë dhe inovacionin, kryesisht drejt ofrimit të shërbimeve të arsimit dhe konsulencës për ndërmarrësit.

Ndërsa për sektorët e TI-së ekzistojnë shumë ndërmjetës relevantë të inovacionit, sektorëve të tjerë të rëndësishëm në Kosovë u mungon mbështetja e tillë sistematike institucionale.

	Stimulation & Awareness	Creation of demands	Targeted Networking	Generation of ideas	Turning ideas into innovations	Commercialisation
Chambers	x	x				
Cluster & Networks			x	x		x
Innovation- / TechTransfer Centers				x	x	
Incubators / Accelerators				x		x
Technology Business Parks			x	x		
Universities					x	

Figura 4: Llojet dhe fushat e ekspertizës së ndërmjetësve të inovacionit përgjatë zinxhirit të inovacionit

Organizatat ndërmjetësuese

Ekzistojnë ndërmjetës të ndryshëm në Kosovë për të mbështetur inovacionin dhe ndërmarrësinë, si (shih Shtojcën 1 për një listë më të gjerë të ndërmjetësve dhe rolet e tyre në mbështetjen e ndërmarrësisë dhe inovacionit). Disa nga to janë iniciuar në kuadër të intervenimeve qeveritare, të tjerat janë zhvilluar si rezultat i projekteve të Donatorëve të Tretë dhe mbështetur nga OJQ-të.

Në vijim janë listuar ndërmjetësit më të rëndësishëm dhe janë përshkruar shkurtimisht:

Innovation Center Kosovo (Qendra Inovative e Kosovës) - përkrah ndërmarrjet, inovacionin dhe zhvillimin e bizneseve me fokus në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për bizneset start-up dhe kompanitë ekzistuese me potencial për rritje. Qendra fokusohet në krijimin e mundësive të reja të orientuara drejt vendeve të punës me bazë në të ardhmen bazuar në njohuritë si dhe teknologjinë e re dhe në inovacion.

STIKK - Shoqata e TIK të Kosovës - u themelua në vitin 2008 nga gjashtë kompani themeluese anëtare. STIKK aktualisht ka mbi 125 anëtarë që përfaqësojnë 90% të tërë tregut të TIK në Kosovë. Gjatë karrierës së vet, STIKK ka zbatuar projekte të shumta që kanë synuar promovim e sektorit të TIK, përmirësimin e kornizës ligjore, zbatimin e hulumtimeve dhe analizave specifike për industrinë, dhe ndihmën në zhvillimin profesional të akterëve kyç të sektorit të TIK. STIKK ka luajtur një rol vendimtar gjatë procesit të hartimit të Strategjisë për Teknologjinë e Informacionit, të sponsoruar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ndërsa Ambasada e Norvegjisë dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ janë të përfshirë në procesin e hartimit të këtij dokumenti.

Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve - Prizren. ITP janë kompani kosovare dhe gjermane aktive në një nga tre sektorët prioritarë (Firma të bazuara në TIK/teknologji, Përpunim bujqësor/ushqimor, Industri kreative dhe kulturore) krijojnë vende të punës, komercializojnë inovacione nga aktivitetet e R&D, zhvillojnë ekonominë dhe ofrojnë mundësi për AAP dhe mësim të bazuar në praktikë.

Bonevet, është një hapësirë krijuese jo fitimprurëse, qëllimi i së cilës është të ndihmojë të rinjtë që të identifikojnë shkathtësitë dhe talentet. Qëllimi i BONEVET është të ndërtojë frymën e kuriozitetit, inovacionit dhe kreativitetit përmes lojës aktive dhe teknologjisë. Organizata aplikon një gamë të gjerë të klasave STEM dhe trajnimet mbështesin fëmijët në përballjen me sfidat e shekullit 21.

Përveç kësaj, Kosova është duke shfrytëzuar burimet ndërkombëtare për të mbushur boshllëkun në intervenimet e politikave për të mbështetur ndërmarrësinë dhe inovacionin. Bizneset marrin mbështetje financiare nga shumë burime nga komuniteti ndërkombëtar, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Botërore (BNRZH, KNF), Komisioni Evropian, SIDA, GIZ, ADA, DFID, USAID, SDC etj. Disa nga këto financime dhe projekte ka të ngjarë të kanalizohen drejt krijimit të produkteve inovative.²²

Mbështetja në nivel qeveritar

Programet qeveritare të financimit për R&D në Kosovë janë të bazuara në Programin Kombëtar për Hulumtime dhe janë zbatuar që nga viti 2010. Një pengesë e madhe për zbatimin e suksesshëm të masave mbështetëse dhe programeve për hulumtim dhe zhvillim është buxheti i kufizuar dhe kapacitetet e kufizuara hulumtuese. Ligji për aktivitetet hulumtuese shkencore nuk është duke u zbatuar siç duhet për shkak të mungesës së fondeve. Shpenzimet e qeverisë për hulumtime kanë rënë në 0.1% të BPV-së. Në arsimin e lartë, cilësia e programeve pasuniversitare për t'u përgatitur për karriera akademike është e dobët, me institucionet private dhe publike të arsimit të lartë që kanë kritere shumë të pabarabarta për promovim bazuar në hulumtimet shkencore dhe publikimet.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes për shkencë dhe kërkim. Sipas raportit të BE-së nuk është bërë shumë progres gjatë vitit të kaluar. Në vitet e ardhshme, Kosova duhet veçanërisht të rrisë shpenzimet qeveritare në hulumtime dhe të kërkojë të stimulojë investimet në sektorin privat duke përgatitur dhe duke përdorur gjetjet e një strategjie të specializimit të

²² <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Western-Balkans-R&D-Kosovo.pdf>, qasur më 2 dhjetor 2018

zgjuar që duhet të zhvillohet nga QK. Kapaciteti i kufizuar hulumtues i Kosovës reflektohet po ashtu edhe në pjesëmarrjen e ulët të Kosovës në Horizonti 2020 BE.

Pjesëmarrja në kuadër të programeve, Kosova merr pjesë në programin e BE-së për hulumtime dhe inovacion Horizonti 2020 (H2020) si palë e tretë, vetëm në cilësinë e vëzhguesit. Kosova ka aplikuar me 10 projekte në programin H2020, ndërsa në vitin 2016 ka aplikuar me dy projekte dhe në vitin 2017 me një projekt, që rezulton të ketë një rritje të vogël në krahasim me vitet e kaluara, por ky nivel i pjesëmarrjes mbetet nën potencialin e Kosovës. Duhet të ndërmerren masa vetëdijesimi, konsultime dhe trajnime me prioritet për të përmirësuar këtë situatë. Prandaj duhet të rritet pjesëmarrja në programin e BE Horizonti 2020 dhe të sigurohet koordinimi më i madh i pikave të kontaktit për Horizontin 2020.

Struktura e politikave

Kur analizohet politika e përgjithshme për inovacionin dhe ndërmarrësinë në Kosovë, vlen të përmendet se nuk ka pasur një politikë kombëtare të qartë dhe të koordinuar për ndërmarrësinë për të fokusuar përpjekjet e akterëve të ndryshëm në sektorin publik si dhe të donatorëve ndërkombëtarë, OJQ-ve dhe akterëve tjerë dhe për të siguruar koherencën në zbatimin e tyre.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në vitin 2017 është themeluar Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe roli i saj është forcimi dhe zhvillimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit. Fokusi i veçantë i MIN tani është në inovacion, i cili është bërë prioritet politik i qeverisë së Kosovës. MIN ka për mision që të stimulojë aktivitetet inovative në Kosovë për të rritur produktivitetin ekonomik dhe institucional, zhvillimin e ndërmarrësisë dhe iniciativën private përmes inovacionit duke u fokusuar në zhvillimin e NVM-ve, mbështetjen për bizneset start-up dhe zhvillimin e ideve dhe iniciativave inovative të aktiviteteve përmes krijimit të Qendrave Rajonale për Inovacion dhe Ndërmarrësi, ku do të trajtohen nga faza e para-inkubimit, inkubimi, përsheptuesit për fuqizim të plotë kur menaxhohen, duke i nënshtruar kushteve të favorshme nga bankat komerciale. Strategjia e MIN për inovacion dhe ndërmarrësi integron të gjitha këto përpjekje të politikave për të mbështetur ndërmarrësinë dhe inovacionin në Kosovë. MIN ka themeluar **Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi** - i cili ka një rol këshillues dhe kryesohet nga Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe përfaqësuesit kyç të ministrive të linjës, organizatat joqeveritare, komuniteti i biznesit si dhe organizatat qeveritare dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare.

Në **mbështetje të bizneseve start-up dhe inovacionit**, është rritur buxheti në nivel qeveritar për promovimin e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Nga viti 2018, MIN ka ndarë mbi 10 milionë euro në total. Nga kjo vlerë, mbi 7 milionë euro janë ndarë për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve që do të investohen për të mbështetur subjektet që, brenda misionit dhe përgjegjësi të tyre, adresojnë fushën e inovacionit dhe kanë një ndikim direkt në rritjen e performancës së NVM-ve dhe bizneseve ekzistuese start-up. Mbi 2 milionë euro nga buxheti i qeverisë synohet të investohen në krijimin e katër Qendrave të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe në funksionalizimin e tyre (rinovim, pajisje laboratorike dhe pajisje tjera shoqëruese).

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) fokusi kyç është hartimi i politikave dhe strategjive për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Republikës së Kosovës si dhe mbështetja e zhvillimit të ekonomisë së tregut, liberalizimi i tregut në shërbimet publike dhe futja e kapitalit privat në përpjekjet publike. Ndër të tjera, fokusi i MZHE-së është të mbështesë teknologjinë e informacionit, inovacionet dhe tregtinë elektronike. MZHE synon të stimulojë zhvillimin e sistemeve të trajnimit të teknologjisë së informacionit. Të gjitha këto role të MZHE janë çështje

ndërsektoriale me strategji për ndërmarrësi dhe inovacion dhe prandaj janë të integruara mirë në këtë dokument strategjik.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë MTI është përgjegjëse për krijimin e kushteve kornizë për tregti, industri, punë komerciale, produkte industriale dhe ndërtimore. Krijon politikë të punës dhe zbaton legjislacionin për të mbështetur konkurrencën e drejtë, politikën e punës dhe zbaton legjislacionin dhe programet për të mbështetur ndërmarrjet industriale dhe komerciale, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Mbështet politikën e punës për zhvillimin e sektorit privat dhe administron sistemin e regjistrimit të bizneseve. **KIESA** në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjëse për koordinimin e politikës gjithëpërfshirëse kombëtare të NVM-ve. KIESA operon në kuadër të MTI-së, që është përgjegjëse për mbështetjen e politikave dhe programeve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Si rezultat, ka pasur shumë programe dhe projekte të pakoordinuara të financuara nga qeveria dhe donatorët. Politika e KIESA-s është e dizajnuar që të përmirësojë sektorin e NVM-ve bazuar në katër komponentë kryesorë: 1. Përmirësimi i Mjedisit Mundësues të Biznesit; 2. Krijimi i Dialogut Publiko-Privat dhe Koordinimi i Donatorëve; 3. Përmirësimi i Konkurrueshmërisë së NVM-ve të Kosovës; dhe 4. Fushata e Informimit Publik. Strategjia e NVM-ve bazohet fuqimisht në dy shtylla kryesore të Strategjisë së BE-së për NVM-të: "Akti për Bizneset e Vogla" (SBA) për Evropë, të cilin Kosova është zotuar ta zbatojë dhe programet kornizë të BE-së Konkurrueshmëria dhe Inovacioni (CIP) që Kosova synon të marrë pjesë në të ardhmen e afërt. Në fushën e mbështetjes së NVM-ve, KIESA ofron subvencione për një pjesë të konsultimeve të biznesit, njohjen e kontributit që NVM-të kanë dhënë për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve, mbajtjen e praktikave dy mujore në komunitetin privat të biznesit, mbështetjen e grave ndërmarrëse për promovimin e produkteve dhe gjetjen e tregjeve të reja, si dhe mbështetjen e kompanive startup që ofrojnë planet më të mira të biznesit.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është themeluar për të kryer funksione në fushën e arsimit dhe shkencës. Sipas Ligjit, MASHT është përgjegjës për krijimin e politikave të veprimit dhe zbatimin e legjislacionit për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Republikën e Kosovës. Mbështet hulumtimet në zhvillimin social, ekonomik, shkencor, teknologjik dhe kulturor të Kosovës. Në kuadër të MASHT-it, Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë ka për detyrë të krijojë një infrastrukturë të mirë, një bazë institucionale dhe financiare për zhvillimin e shkencës, hulumtimeve shkencore dhe promovimin e zhvillimeve dhe aplikacioneve bashkëkohore teknologjike në ekonominë e Kosovës. MASHT-i operon një skemë granti që siguron grante të cilat ndahen për institucione të hulumtimeve shkencore dhe të cilat kushtëzohen nga elementi i inovacionit. Numri total i granteve të alokuara nga MASHT është 82 me një buxhet total prej 600,000 euro. Nuk ka plan qeveritar për të stimuluar NVM-të që të bashkëpunojnë me Akademinë dhe të orientohen drejt inovacionit dhe nuk ka bashkëpunim ndërmjet ministrive ose organeve të përbashkëta ndërministrorë (PRE, 2016). Përveç kësaj, një rol themelor në formësimin e politikës së Kosovës për R&D mbahet nga **Këshilli Kombëtar i Shkencës (KKS)**. MASHT ka buxhet shumë të kufizuar për të vendosur në mënyrë efektive një program gjithëpërfshirës të politikave të hulumtimit dhe inovacionit. Në fakt, përvoja e Ministrisë në financimin dhe zbatimin e programeve të politikave të hulumtimit është shumë e freskët. Aktualisht, KKS nuk është duke funksionuar. Strategjia kombëtare për R&D përshkruhet në Programin Kombëtar për Hulumtime 2010-2015. Ai trajton elementët kyçe që janë relevante për të forcuar aftësitë hulumtuese në Kosovë. Si i tillë, përfshin dispozita për të zhvilluar kapacitetet njerëzore, infrastrukturën hulumtuese, bashkëpunimin ndërkombëtar, lidhjen e shkencës me bizneset, dhe alokimet buxhetore. **Qendra për Mbështetje të Inovacionit dhe Transfer të Teknologjisë (QITT)** është pjesë e Departamentit për Teknologji dhe Shkencë brenda

MASHT. Ajo synon të zgjerojë lidhjet ndërmjet shkencës, teknologjisë, dhe akterët e industrisë për të përshpejtuar procesin e transferit të teknologjisë, zhvillimit të teknologjisë, dhe inovacionin në Kosovë. QMITT ofron mbështetje për ndërmarrësit dhe asistencë në lidhje me patentueshmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave tjera të pronësisë intelektuale.

Ministritë tjera të përfshira në sistemin e përgjithshëm të SHTI në Kosovë përfshijnë **Ministrinë e Financave**, veçanërisht në fushën e buxhetimit; **Ministrinë e Administratës Publike**, veçanërisht në fushën e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe **Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale**, veçanërisht në fushën e punësimit dhe bashkëpunimit me MASHT në çështjet e zhvillimit të tregut të punës. Brenda QK ekzistojnë disa programe/projekte për të mbështetur startup-et në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KIESA-s, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shumë donatorëve tjerë. Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi synon të shërbejë si një ombrellë për politikën e ndërmarrësisë dhe inovacionit në Kosovë.

Mjedisi ligjor për Ndërmarrësi dhe Inovacion

Synimi i MIN është hartimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi për të plotësuar kornizën ligjore. Ekzistojnë një numër ligjesh që lidhen me mbështetjen e ndërmarrësisë dhe inovacionit:

- Ligji Nr. 2004/49 për Patentim, Ligji Nr. 02/L-100 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/49 për Patentim". Ky ligj përcakton dispozitat dhe procedurat për regjistrimin e patentës, të drejtat që dalin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.
- Ligji Nr. 04/L-135 PËR VEPRIMTARI KËRKIMORE-SHKENCORE. Ky ligj rregullon: themelimin, veprimtarinë, organizimin, qeverisjen, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve dhe hulumtuesve shkencorë në këtë veprimtari; pozitën e Këshillit Kombëtar të Shkencës, bazat e financimit të veprimtarisë hulumtuese-shkencore, si dhe çështje të tjera në lidhje me veprimtarinë hulumtuese-shkencore në Kosovë.
- Ligji Nr. 04/L-006 për Shoqëritë Tregtare përcakton llojet e shoqërive tregtare përmes të cilave mund të kryhet veprimtaria e biznesit në Kosovë. Gjithashtu përcakton kërkesat e regjistrimit për secilin lloj të shoqërisë tregtare, liston dispozitat ligjore të zbatueshme për secilin lloj të shoqërisë tregtare në lidhje me kapacitetin dhe strukturën e vet ligjore, si dhe të drejtat dhe detyrimet si subjekte ligjore, të pronarëve, menaxherëve, drejtorëve, përfaqësuesve ligjorë dhe palëve të treta;
- Ligji Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut përcakton funksionet mbikëqyrëse inspektuese si dhe operacionet dhe autorizimet e inspektorëve të tregut, të cilët janë përgjegjës për implementimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore për mbikëqyrjen e inspektimit;
- Ligji Nr. 04/L-005 për Tregtinë e Brendshme rregullon kërkesat për kryerjen e tregtisë në tregun e brendshme (duke përfshirë shitjen me shumicë dhe shitjen me pakicë), ankandin, ndërmjetësimin në tregti, praktikat kufizuese, si dhe masat mbrojtëse për kryerjen e veprimtarisë së tregtisë, masat mbikëqyrëse, dhe masat administrative dhe ndëshkuese kundër konkurrencës së paligjshme në kontekstin e tregut të brendshëm;
- Ligji Nr. 05/L-079 për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës synon të stimulojë, tërheqë dhe krijojë kushte për zbatimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës, si dhe të krijojë procedura administrative dhe kritere për vlerësimin, përzgjedhjen, zbatimin dhe monitorimin e projekteve strategjike, si dhe përcaktimin e

procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës, me qëllim të zbatimit të projekteve të investimeve strategjike.

- Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike (datë 04.03.2013) është hartuar për të rregulluar iniciativat për krijimin e zonave ekonomike, zonave të lira ekonomike, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e përdorimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave ekonomike, hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike dhe krijimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike.
- Ligji Nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (datë 22 korrik 2015). Ky Ligj përcakton sistemin e Tatimit në të Ardhurat Personale në territorin e Republikës së Kosovës.
- LIGJI NR. 04/L-220 për Investimet e Huaja (dhjetor 2013) ka për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë duke u ofruar investitorëve të huaj një grup të të drejtave dhe garancive themelore dhe të zbatueshme, me qëllim të sigurimit se ata dhe investimet e tyre mbrohen dhe trajtohen me drejtësi dhe respekt, në përputhje të rreptë me sundimin e ligjit dhe standardet dhe praktikat ndërkombëtare gjerësisht të pranuar.
- Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, datë 7 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës). Ky ligj ndryshoi Ligjin 2004/36. Ky ligj përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencave, organizimin e Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe procedurat për zbatimin e këtij ligji.
- Ligji për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159. Ky ligj synon krijimin e zonave ekonomike, zonave të lira ekonomike, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e përdorimit të zonave ekonomike, promovimin e zonave ekonomike, hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike dhe krijimin e këshillit kombëtar për zonat ekonomike.
- Ligji Nr. 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (16 qershor 2004 me shpallje më 28 korrik 2004).
- Ligji nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (26 shtator 2002, i cili është shpallur më 12 maj 2003).
- Ligji Nr. 2011/04-L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë (31 gusht 2011).

3.4 Analiza SWOT

Në bazë të informacionit të paraqitur brenda kapitullit të Analizës, pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe rreziqet kosovare në lidhje me inovacionin dhe ndërmarrësinë janë përmbledhur në tabelën SWOT më poshtë. Megjithëse dobësitë aktualisht duket se i kalojnë pikat e forta, konsultimet me akterë të ndryshëm kanë treguar potencialet ekzistuese në fusha specifike, ku megatrendet dhe sfidat shoqërore ofrojnë perspektiva dhe mundësi për zhvillim të ardhshëm. Tabela 2 paraqet analizën SWOT që rrjedh nga analiza e kryer.

Tabela 2. Analiza SWOT

Pikat e forta	Pikat e dobëta
---------------	----------------

<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rritja e vazhdueshme në dekadën e fundit • Inovacioni dhe Ndërmarrësia janë lartë në agjendën politike dhe përfaqësohen mirë, Ekzistenca e Ministrisë së Ndërmarrësisë • Rritja e harmonizimit të politikës industriale dhe inovative të Kosovës me politikat dhe programet mbështetëse të BE-së për NVM • Legjislacion dhe kornizë strategjike të qëndrueshme në lidhje me TIK • Ndërlidhshmëri e mirë midis komunave, kombinuar me disponueshmërinë e harduerit dhe softuerit bazë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Investime të ulëta publike në Inovacion dhe Ndërmarrësi • Aftësi e ulët e sektorit privat për të investuar në inovacion • Korniza institucionale e inovacionit dhe ndërmarrësisë nuk është plotësuar ende • Koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe kompanive private • Koordinim i dobët ndërmjet akterëve të trajnimit dhe arsimit. • Sektori akademik nuk është i gatshëm për të ofruar shërbime ndaj sektorit privat si ofrues i zgjidhjes së inovacionit • Mungesa e krijimtarisë për bashkëpunim industrial-akademik • Korniza ligjore që lidhet me inovacionin nuk është plotësuar
<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Disponueshmëria e një numri të vogël të profesionistëve të diplomuar jashtë vendit, por të mirë-arsimuar • Popullsia më e re në Evropë, e aftë për t'u përballur me transformimin digjital të shoqërisë dhe industrisë, • Numri në rritje i firmave shumë inovative dhe konkurruese në nivel ndërkombëtar (kryesisht nga sektori i TIK) • Zhvillimi i shpejtë i infrastrukturës mobile dhe internetit • TIK si mundësues për digjitalizimin e industrive të tjera të rëndësishme • Niveli i mirë i bashkëpunimit midis kompanive • Bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat, sektorit arsimor dhe qeverisë 	<p>Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet akterëve publikë dhe privatë mund të pengojë progresin e shpejtë • Roli i paqartë dhe kapacitetet e ulëta të ndërmjetësve të inovacionit pengojnë rolin e tyre për të mbështetur industrinë kombëtare që të bëhet më inovative • Shterja e trurit të ndërmarrësve të rinj të mirë arsimuar për shkak të mungesës së mundësive të biznesit • Firmat inovative largohen nga Kosova ose blihen nga firmat e huaja • Oferta e të diplomuarve në TIK nuk plotëson kërkesën e industrisë • Mungesa e investimeve publike në inovacion dhe ndërmarrësi nuk do të çojë në ndikimin e dëshiruar

4. ÇFARË SYNON TË ARRIJË STRATEGJIA

Bazuar në rezultatet e analizës së gjendjes aktuale dhe sfidave të ardhshme të inovacionit dhe ndërmarrësisë, Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi përcakton vizionin deri në vitin 2022, objektivat strategjike dhe objektivat operacionale të dedikuara. Këto të fundit janë grupuar sipas katër shtyllave tematike (Fig. 5).



Figura 5: Llojet dhe detyrat tipike të ndërmjetësve të inovacionit

Shtylla përkatëse tematike, objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara, si dhe një sërë masash konkrete mbështetëse, synojnë të kontribuojnë në vizionin e rënë dakord bashkërisht, vizioni 2022. Rënia dakord për një vizion të përbashkët është detyrë e rëndësishme në kuadër të zhvillimit të strategjisë, veçanërisht pasi përfshihen shumë akterë të ndryshëm, dhe duhet të kontribuojnë në mënyrë sistematike.

Vizioni 2022

Deri në vitin 2022, Kosova duhet të bazojë konkurrencën e saj ekonomike në shfrytëzimin efektiv të njohurive, kreativitetit dhe inovacioneve dhe të njihet ndërkombëtarisht si qendër e orientuar digjitale, e njohur në nivel rajonal për inovacione dhe hulumtime shkencore me efekte ekonomike dhe të bëhet një qendër rajonale për zhvillimin e ekonomisë digjitale.

Misionin që Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi e ndjek mund të përkufizohet si në vijim "Sistemi Kosovar për inovacion zbaton një qasje të integruar për investim në njohuri, kreativitet dhe inovacion, nga njëra anë, dhe për promovimin e shkëmbimit midis komunitetit kombëtar të inovacionit dhe ndërmarrësisë, si dhe me ekspertët ndërkombëtar, në anën tjetër. Prandaj, do të krijohen kushte të favorshme kornizë për të rritur konkurrencën ndërmjet bizneseve të Kosovës, si dhe përmirësimin e mirëqenies sociale.

Objektivat strategjike të përcaktuara në Strategjinë për Inovacion dhe Ndërmarrësi paraqesin një aspirim më të përgjithshëm, të paktën pesë vjeçar, në formën e një deklarate lidhur me kushtet e preferuara që QK-ja do të angazhohet t'i arrijë. Në vijim janë përcaktuar objektivat strategjike, të cilat do të lidhen me problemet e identifikuar dhe shkaqet e tyre. Ato automatikisht trajtojnë të tri nivelet, atë të politikave (nivele makro), të ndërmjetësimit (nivele mesatar), dhe të industrisë

dhe akademisë (niveLIN mikro). Kjo qasje sistematike ka gjasë të kontribuojë në përmbushjen e të gjitha objektivave të ndërlidhura (Figura 5).

Katër objektivat strategjike janë

1. Përmirësimi i politikave publike për iniciimin dhe zhvillimin e inovacioneve, me fokus në rritjen e konkurrencës dhe potencialit eksportues të Republikës së Kosovës
2. Rritja e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe akademisë, si dhe bashkëpunimit në investimet e përgjithshme në hulumtime dhe zhvillime.
3. Krijimi i mekanizmave të fuqishëm të koordinimit për inovacion dhe ndërmarrësi në nivel kombëtar
4. Ngritja e kapaciteteve dhe kompetencave njerëzore për kërkim, zhvillim dhe inovacion në ndërmarrësi




Figura 6: Hierarkia e katër objektivave strategjike

5. SHTYLLAT TEMATIKE DHE OBJEKTIVAT OPERACIONAL

Një sërë shtyllash tematike janë përcaktuar për arritjen e objektivave strategjike dhe mbështetjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Kosovë. Me qëllim të koordinimit dhe zbatimit efektiv, në këto shtylla tematike dhe në përputhje me objektivat operacionale, do organizohen masa dhe veprime të ndryshme të përcaktuara. Këto shtylla formojnë një portofol të integruar të masave mbështetëse, të cilat mund të përshtaten shpejt me ndryshimin e kushteve dhe nevojave të tregut.

Janë përcaktuar një sërë objektivash operacionale për secilën prej shtyllave tematike. Objektivi operacional specifikon rezultate më konkrete, duke u fokusuar më ngushtë në një aspekt brenda një shtylle të caktuar tematike, zakonisht me një perspektivë afatshkurtër (ose afatmesme). Nga njëra anë, objektivat specifikë janë përcaktuar për të siguruar orientime më të sakta për veprime, dhe secila duhet të arrihet përmes zbatimit të një numri të caktuar veprimesh. Kurse, nga ana tjetër, ato janë të lidhura me një objektiv të përgjithshëm dhe përfaqësojnë mënyrën për ta arritur atë.

QK-ja do zbatojë një sërë instrumentesh për zbatimin e Strategjisë, si:

- Instrumentet rregullative – që përcaktojnë të drejtat, detyrimet, kufizimet ose standardet e përcaktuara në ligje dhe akte nënligjore
- Instrumentet administrative – që përfshijnë ofrimin direkt ose indirekt (p.sh. kontraktimin) e shërbimeve, investimet në infrastrukturë, ngritjen e kapaciteteve (trajnimet), inspektimin, etj.
- Instrumentet informative – që përfshijnë fushatat për shpërndarjen e informacioneve, publikimet dhe zhvillimin e ueb faqeve të reja të informacioneve, etj.
- Instrumentet institucionale – që përfshijnë krijimin ose riorganizimin e institucioneve publike për të siguruar përmbushjen e funksioneve të nevojshme shtetërore, ose ofrimin e shërbimeve publike, dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.
- Instrumentet financiare – që përfshijnë subvencionet, zbritjet e taksave, garancitë, kushtet e favorshme tregtare, etj. Në PAR, këto përdoren rrallë, megjithëse, mund të futen gjopa të reja ose stimuj financiarë.

5.1 Shtylla Tematike A: Zhvillimi i një sistemi të integruar për inovacion në Republikën e Kosovës dhe avancimi i kushteve të kornizës ligjore dhe fiskale

Shtylla Tematike A	Zhvillimi i një sistemi të integruar për inovacion në Republikën e Kosovës dhe avancimi i kushteve të kornizës ligjore dhe fiskale
Shpjegimi	<p>Institucionet përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës duhet të përfshihen në një sistem efikas të krijimit të inovacionit me efekt mbi ekonominë, si dhe kornizën ligjore dhe fiskale. Kushtet e përshtatshme kornizë mundësojnë orientimin e kapaciteteve hulumtuese dhe shkencore të sektorit publik dhe privat në aspektin e përdorimit të inovacionit në ekonomi dhe përdorimit të teknologjive të reja për të rritur konkurrencën. Këshilli Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të jetë platforma këshilluese për ndërtimin e një sistemi të integruar të inovacionit dhe ndërmarrësisë. Qëllimi afatgjatë është të zbatohet një qasje sistematike dhe të integruar për inovacionin dhe ndërmarrësinë, përfshirë kushtet e përshtatshme ligjore dhe fiskale.</p>
Objektivi operativ A.1:	<p>Të harmonizohet mirë zbatimi i Strategjive për Inovacion dhe Ndërmarrësi, me iniciativat e ndërlidhura</p> <p>Për të shmangur tepricat dhe për të nxitur potencialet e sinergjisë ndërmjet strategjive të ndryshme të Qeverisë së Kosovës, duhet të zhvillohen më tej mekanizmat koordinues, si Këshilli Ndër-Ministror Këshillëdhënës për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Me këtë gjë, mund të arrihen sinergji të konsiderueshme midis strategjive të ndryshme. Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi mund të shërbejë si strategji e përgjithshme me orientim integral holistik. Në këtë aspekt, Strategjia për TI e Kosovës, Strategjia e Specializimit të Mençur, dhe strategji tjera specifike sektorale ose për teknologjinë, fokusohen në fusha të caktuara me formulime më konkrete të qëllimeve dhe fushave të veprimit. Në këtë kontekst, duhet të përcaktohen përgjegjësi të qarta midis të gjitha institucioneve të interesuara.</p>
Objektivi operativ A.2	<p>Të përmirësohen përgjegjësitë dhe detyrat operacionale të ndërmjetësve kosovarë të inovacionit</p> <p>Ndërmjetësit e inovacionit po luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin kombëtar të inovacionit. Megjithatë, numri i tyre është ende i kufizuar (p.sh. Odat, ITP Prizren ose ICK), roli i tyre është i rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes për sektorin privat në aspektin e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Gjithashtu, është e rëndësishme që këta ndërmjetës të inovacionit të kenë detyra dhe objektiva të dedikuara në mënyrë që të bashkëpunojnë në një mënyrë të synuar, dhe të shmangin konkurrencën ose tepricat midis tyre. Prandaj, nën udhëheqjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe/ ose Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi, janë vendosur mekanizma koordinimi që sigurojnë funksionim të efektshëm të ndërmjetësve përkatës të Inovacionit. Modelet stimuluese për ndërmjetësit e inovacionit mund t'i</p>

	ndihmojnë ata të ndjekin një qasje të tillë të modernizuar. Krijimi i ndërmjetësve të rinj të inovacionit bëhet atëherë kur ndihet nevoja e tyre.
Objektivi operacional A.3:	<p>Të instalohen instrumentet sistematike të politikës fiskale dhe jo-fiskale për promovimin e aktiviteteve të inovacionit</p> <p>Bazuar në Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, së bashku me Këshillin Këshillëdhënës për Inovacion dhe Ndërmarrësi, duhet të zhvillojë një grup instrumentesh politikë për të mbështetur aktivitetet e inovacionit, të cilat trajtojnë nevojat dhe potencialet e peizazhit rajonal ekonomik dhe shkencor. Stimujt e taksave, grantet, inovacionet dhe programet e financimit të ndërmarrësisë janë mundësitë që duhet të merren parasysh për nxitjen e zhvillimit horizontal ekonomik (p.sh. infrastruktura fizike, siç janë inkubatorët, infrastruktura digjitale), si dhe zhvillimit vertikal ekonomik, i cili fokusohet në fusha të caktuara teknologjike dhe inovative që kanë potencial për të nxitur rritjen ekonomike.</p>

5.2 Shtylla tematike B: Rritja e potencialit për inovacion në ndërmarrjet Kosovare

Shtylla tematike B	Rritja e potencialit për inovacion në ndërmarrjet Kosovare
Shpjegimi	Ekziston një nevojë e madhe që potenciali inovativ dhe konkurrenca e ekonomisë të forcohet, duke ofruar mbështetje për krijimin e ndërmarrjeve inovative, gjithashtu duke mbështetur investimet në proceset dhe teknologjitë inovative, hulumtimin e tregut, zhvillimin dhe inovacionin teknologjik si dhe mbështetjen dhe lehtësimin e mbështetjes financiare për tërheqjen e investimeve të huaja për inovacion dhe ndërmarrësi.
Objektivi operacional B.1	<p>Të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e inovacionit në sektorin privat</p> <p>Ndërgjegjësimi mbi rëndësinë dhe potencialin që inovacioni dhe ndërmarrësia e ka, nuk është kuptuar plotësisht nga sektori privat, por as nga ai publik. Fushatat e komunikimit dhe informimit për rritjen e ndërgjegjësimit janë mjete të rëndësishme për të kontribuar në një shoqëri Kosovare më të orientuar në inovacion. Është thelbësore të sigurohet transparencë dhe informacione përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit në mënyrë që grupi kryesor i synuar, të adresohet në mënyrë të duhur. Subjektet administrative në nivel lokal, komuniteti për biznes dhe hulumtim, si dhe qytetarët duhet të sensibilizohen lidhur me inovacionin dhe ndërmarrësinë.</p>
Objektivi operacional B.2	<p>Të zbatohet një skemë mbështetëse programatike dhe institucionale për inovacionin dhe ndërmarrësinë, në mënyrë efikase</p> <p>Zhvillimi dhe zbatimi i një skeme mbështetëse sistematike në nivelin programor dhe institucional është gjëja thelbësore për Strategjinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Ajo ka për synim të mbështesë kushtet kornizë për të lehtësuar inovacionin për NVM-të dhe për të fuqizuar ndërmarrësinë në dy mënyra. Gjithashtu, përmban skema gjenerike të mbështetjes programore të inovacionit (p.sh. fondet, subvencionet etj.) që synojnë përmirësimin e gatishmërisë së inovacionit dhe aftësisë së NVM-ve në të gjitha sektorët. Për më tepër, synon të fuqizojë dhe modernizojë peizazhin ndërmjetësues të inovacionit. Gjithashtu, po nxitet ardhja e ndërmjetësve të rinj të inovacionit (atëherë kur është e nevojshme), dhe e mekanizmave të zbatuara të koordinimit, për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e ndërmjetësve të inovacionit. Të gjitha këto skema mbështetëse duhet të jenë të orientuara nga kërkesa, dhe të lehta për tu qasur për të gjithë grupin e synuar.</p>
Objektivi operacional B.3	<p>Të transferohen në mënyrë efikase rezultatet e R&D, në zgjidhje të tregtueshme nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet akademisë dhe hulumtimit me sektorin privat</p>

	<p>Me qëllim të përshtatjes sa më të mirë të kurrikulave të arsimit të lartë dhe kërkesave të biznesit, Strategjia e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë promovon një angazhim më të madh të sektorit privat dhe atij akademik. Investimet në akademi dhe biznes duhet të harmonizohen dhe të pasurojnë njëra tjetrën, me fokus në fushat prioritare, duke përfshirë digjitalizimin dhe TI-në si fusha kryesore dhe ndërsektoriale. Për më tepër, duhet të nxitet përfshirja e studentëve në punët praktike të kompanive.</p>
Objektivi operacional B.4	<p>Të promovohet inovacioni nëpërmjet investimeve të huaja dhe promovimit të eksportit</p> <p>Me qëllim të plotësimit të boshllëqeve në zinxhirët shumë relevant të vlerave, dhe të ofrimit të mundësive tërheqëse për punësim, duhet të zhvillohet një fushatë marketingu për vendin, së bashku me shtetet fqinje të Ballkanit Perëndimor, me qëllim që të sigurohet vizibilitet më i lartë. Gjithashtu, duhet të vazhdojë një bashkëpunim i ngushtë me ekspertët dhe institucionet e huaja, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të integritetit të Kosovës në tregun evropian, si vend biznesi. Në kontekstin e politikës rajonale të Bashkimit Evropian (Politika e Kohezionit), projektet inovative tranzicionale mund të shërbejnë si bazë testimi për idetë e reja të inovacionit, dhe si mundësi për të përfituar nga shkëmbimi i njohurive me partnerët e tjerë, dhe gjithashtu për të mësuar nga praktikatat më të mira.</p>

5.3 Shtylla tematike C: Mbështetja e inovacionit dhe ndërmarrësisë ndërmjet të rinjve dhe grave në biznese

Shtylla tematike C	Mbështetja e inovacionit dhe ndërmarrësisë ndërmjet të rinjve dhe grave në biznese
Shpjegimi	<p>Universitetet konsiderohen të jenë një burim shumë i rëndësishëm i inovacionit. Bashkëpunimi i studentëve dhe profesorëve me sektorin privat krijon një vlerë të shtuar të procesit arsimor dhe ndihmon në ndërtimin dhe avancimin profesional të gjeneratave të reja. Aktualisht, as skemat e formimit profesional, as kurríkula e arsimit të lartë nuk korrespondojnë me nevojat e ekonomisë. Studentët dhe të diplomuarit nuk janë plotësisht në gjendje të aplikojnë njohuritë e tyre në ekonomi, për shkak që atyre iu mungojnë njohuri të rëndësishme lidhur me inovacionin dhe ndërmarrësinë. Kjo shtyllë synon të promovojë bashkëpunimin e ngushtë me sektorin privat në botën akademike, duke nxitur përfshirjen e studentëve në praktika, si dhe mbështetjen financiare për të rinjtë dhe gratë në biznese, me anë të trajnimeve profesionale shtesë. Masat e ndërlidhura synojnë të rrisin përfaqësimin</p>

	aktual të grave në biznes, i cili aktualisht është i ulët - vetëm 10% e pronarëve të bizneseve në Kosovë përfaqësohen nga gratë. ²³
Objektivi operacional C.1	<p>Të rritet shpirti inovativ dhe ndërgjegjësimi tek talentët e rinj</p> <p>Kreativiteti është forca fillestare për inovacion. Thelbësore për inkorporimin e inovativitetit dhe të menduarit në mënyrë ndërmarrësore janë investimet në kapitalin njerëzor, të cilat duhet të organizohen bazuar në një qasje holistike. Kjo është arsyeja se pse masat kombëtare duhet të zbatohen në fillim të zinxhirit të inovacionit "arsim - hulumtim - biznes". Kurrikula duhet të modifikohet në përputhje me rrethanat, duke marrë parasysh aftësitë digjitale dhe ato ndërmarrësore, kompetencat e medias, aftësitë e buta, si dhe metodat inovative të mësimdhënies. Për më tepër, iniciativat jashtë kurrikulës për promovimin e talentëve të ri mund të shërbejnë si nxitje për të mbështetur dëshirën për të eksperimentuar dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve.</p>
Objektivi operacional C.2	<p>Të harmonizohen kurrikulat e aftësimi profesional dhe arsimit të lartë me kërkesat e ndërmarrësisë dhe ekonomisë</p> <p>Kurrikulat e aftësimi profesional dhe arsimit të lartë duhet të jenë të hartuara në atë mënyrë që ta trajtojnë këtë çështje duke inkorporuar përmbajtjet përkatëse të kurseve, dhe duke ofruar infrastrukturë. Gjithashtu, duket të ofrohen stimuj për studentët dhe hulumtuesit për t'i zhvilluar dhe kontribuar më shumë talenteve të tyre. Bursat ose garat e inovacionit mund të jenë pjesë përbërëse e ndonjë nga instrumenteve të mundshme.</p>
Objektivi operacional C.3	<p>Të integrohen më shumë gratë në biznes, përmes programeve të veçanta mbështetëse</p> <p>Sidomos në vendet që janë në zhvillim e sipër, si Kosova, gratë ballafaqohen me pengesa të konsiderueshme për shkak të pikëpamjes tradicionale të rolit të grave, si dhe qëndrimeve dhe stereotipave të pafavorshme shoqërore. Rrjedhimisht, udhëheqja e një biznesi, ose puna si një punonjëse konsiderohet si shumë më e vështirë për gratë. Thelbësore për nxitjen e konsiderueshme të potencialit të rritjes ekonomike, është që gratë të marrin një rol aktiv në ekonomi, si sipërmarrëse ose si punëtore. Zhvillimi i një mjedisi mbështetës biznesi për sipërmarrëset femra është parakusht thelbësorë për atë gjë. Programet specifike të financimit dhe krijimi i grupeve kombëtare ose lokale të interesit mund të shënojnë një pikënisje.</p>

²³ BERZH 2016, INSTITUTI RIINVEST 2017

5.4 Shtylla tematike D: Promovimi dhe trajtimi i inovacioneve në sektorët me potencial për zhvillim ekonomik

Shtylla tematike D	Promovimi dhe trajtimi i inovacioneve në sektorët me potencial për zhvillim ekonomik
<p>Shpjegimi</p>	<p>Që një kohë të gjatë, zhvillimi ekonomik i Kosovës bazohet në burimet natyrore dhe në zhvillimin e sektorëve të industrisë së lehtë. Kjo gjë nuk i garanton Kosovës konkurrueshmëri në tregjet rajonale dhe botërore, për shkak që zhvillimet e fundit në ekonominë botërore argumentojnë që konkurrueshmëria bazohet në investimet për nxitjen e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Fusha e shërbimeve të mbështetura nga zhvillimet teknologjike, inovacionet në proceset e prodhimit, marketingu, administrimi, tregtia, bujqësia dhe shëndetësia janë e ardhmja e ekonomisë së Kosovës. Kjo shtyllë ka për synim fillimin e debatit lidhur me të menduarit ndryshe sa i përket ekonomisë, ku parashihet shfrytëzimi i teknologjisë informatave për zhvillimin e sektorëve të ekonomisë, me qëllim të rritjes së efekteve ekonomike. Kjo strategji mundëson zbatimin e ekonomisë digjitale dhe prodhuese në çdo sektor zhvillimor të vendit.</p>
<p>Objektivi operacional D.1</p>	<p>Të krijohet një instrument horizontal i politikës, me qëllim të ofrimit të kushteve sa më të mira kornizë në ekonomi dhe hulumtim, dhe të krijojë themelet për qasjet pasuese me orientim në sektorët specifik.</p> <p>Para se të bëhet nxitja dhe investimi në fusha të caktuara ekonomike prioritare, duhet të zbatohen masa neutrale sektorale për të krijuar kushtet e nevojshme kornizë, për një sistem funksional të inovacionit (shih gjithashtu B.2). Mbi këtë bazë, hapi tjetër për rritjen e konkurrencës është zhvillimi dhe zbatimi i politikave jo neutrale, gjegjësisht temave specifike për fusha të caktuara tematike me potencial të madh në të ardhmen.</p>
<p>Objektivi operacional D.2</p>	<p>Të kanalizohen investimet në fushat ekonomike dhe të inovacionit, me potencial të madh të zhvillimit ekonomik</p> <p>Bazuar në një analizë të shëndoshë në kornizën e një Strategjie të Specializimit të Mençur, duhet të përcaktohet një përzgjedhje e fushave specifike me fuqi, me potencial për të nxitur rritjen ekonomike dhe transformimin e strukturave ekzistuese. Fokusi duhet t'i kushtohet Aktiviteteve Transformuese (kapitulli 6). Potenciali endogjen duhet të kombinohet në mënyrë inteligjente me trendët teknologjike, siç është digjitalizimi, me qëllim të identifikimit dhe promovimit të fushave të reja ekonomike. Zhvillimi i kapaciteteve plotësuese, iniciativave dhe shërbimeve specifike, për këto fusha specifike, kërkon investime prioritare. Kështu, mund të ndërtohen USP-të të cilat ndihmojnë në përmirësimin e konkurrencës kombëtare.</p>

Objektivi operacional D.3	<p>Të ndërthurët promovimi i industrive të prioritizuara me ekonominë digjitale</p> <p>Në kombinim me strategjinë kombëtare të TI-së dhe strategjinë e specializimit të mençur, zhvillimi i zonave prioritare duhet të shoqërohet me digjitalizimin dhe masat strategjike që rrjedhin nga kjo. Ky integrim i ngushtë është thelbësor për transformimin e suksesshëm drejt një ekonomie të bazuar në dije. Industria e TI-së në Kosovë konsiderohet si motori kryesor për zhvillimin dhe rritjen e ardhshme ekonomike. Duhet të përfshihet në të gjitha pjesët e zinxhirit të inovacionit, nga arsimi i mesëm deri tek zhvillimi i biznesit.</p>

6 Prioritizimi i sektorëve të Kosovës me potencial të lartë për zhvillim ekonomik

Për shkak të statusit embrional të sistemit të inovacionit dhe ndërmarrësisë në Kosovë, Strategjia përbëhet kryesisht nga masat horizontale dhe politikat neutrale, me qëllim të përmirësimit të kushteve të përgjithshme kornizë, dhe aftësive për inovacion dhe ndërmarrësi. Sidoqoftë, shtylla tematike D thekson një logjikë më vertikale dhe jo neutrale të ndërhyrjes, për shqyrtim më të mirë të kapaciteteve dhe mundësive për transformim, dhe për të krijuar masën kritike në fusha të reja inovative me potencial rritjeje mbi mesataren. Fokusi do të jepet në promovimin e të ashtuquajturave Aktiviteteve Transformuese, meqë ato zakonisht tregojnë potencial rritjeje mbi mesataren. Ideja e aktiviteteve transformuese (AT) ka qenë e qenësishme në konceptin e S3, pasi që ky i fundit, u formalizua së pari në vitin 2009 nga Foray. Në këtë kontekst, aktivitetet transformuese mund të përkufizohen si një numër aktiviteteve të lidhura me inovacionin, të kryera nga një grup akterësh që synojnë të njëjtën fushë (teknike, të tregut ose industriale), duke pasur potencial për të transformuar industrinë ekzistuese në mënyrë të konsiderueshme. Sidoqoftë, ato janë gjithmonë të vështira për t'u identifikuar, meqë mungojnë statistikat dhe treguesit tradicionalë.

Për të identifikuar dhe prioritzuar këta sektorë relevantë për Kosovën, janë përfshirë një game e gjerë akterësh, të mbështetur nga analiza statistikore. Rreziku i ndjekjes së interesave të ngushta sektoriale u kufizua nga një proces i fuqishëm i moderimit, një aplikim konsistent i metodologjisë dhe me vërtetimin e vlerësimeve dhe propozimeve për të dhënat ose provat tjera. Proceset çuan në identifikimin e katër sektorëve (Fushat Prioritare) ku dinamika e lartë e inovacionit dhe potencialet e rritjes mbi mesatare pritet të ndodhin në të ardhmen.

- TIK dhe industria e ndërlidhur digjitale
- Prodhimi dhe përpunimi i ushqimit
- Prodhimi industrial
- Turizmi dhe industria e ndërlidhur e shërbimit

Praktika na tregon që aktivitetet transformuese shfaqen midis dy ose disa fushave prioritare, të cilat zakonisht përfaqësojnë sektorë të fuqishëm ekonomikë. Prandaj, Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi do zbatojë Qasjen Diamant të Sinergjisë S3 (Meier zu Köcker et al 2017), e cila bazohet në supozimin se veprimet transformuese kryesisht shfaqen ndërmjet sektorëve të fuqishëm si rezultat i rritjes së konvergencës industriale. Diamanti i Sinergjisë S3 për Kosovë i grupoi katër këndet e identifikuara të Fushave Prioritare dhe supozon identifikimin e Aktiviteteve Transformuese ndërmjet tyre (Figura 6). Disa aktivitete transformuese, të cilat mund të jenë relevante për këtë strategji dhe për ekonominë kosovare, jepen me figura. Megjithatë, kërkesa përfundimtare e identifikimit kërkon analiza më solide.

Rrjedhimisht, Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të funksionalizojë identifikimin dhe zhvillimin e Aktiviteteve Transformuese, që rrjedhin ndërmjet këtyre katër Fushave Prioritare, duke promovuar të ashtuquajturat Proceset zbuluese të ndërmarrësisë, të cilat zhvillojnë veprime konkrete, zbatimi i të cilave gjeneron masën e nevojshme kritike për transformimin strukturor në Kosovë. Gjenerimi i masës kritike pre-supozon të shfrytëzojë lidhjet ndërsektoriale (konektivitetin) dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. I gjithë procesi duhet të jetë përpjekje kolektive duke përfshirë të gjithë akterët relevantë të procesit të inovacionit. Nga identifikimi e deri tek monitorimi i këtyre aktiviteteve transformuese, grupimet (klasterët) janë akterët

kryesorë. Ata janë të vendosur në një nivel granulariteti midis firmave individuale dhe sektorëve të gjerë, dhe bashkojnë akterët e spirales së katërfishte, pasqyrojnë lidhjen dhe janë të përcaktuar të përfitojnë drejtpërsëdrejti nga proceset S3 të përmirësuara të inovacionit. Zhvillimi i grupit është pjesë e kësaj strategjie, dhe strategjive të tjera, duke demonstruar rëndësinë në rritje të grupimeve, sa i përket zhvillimit ekonomik të Kosovës.




Figura 5: Diamanti i sinergjisë S3 i Republikës së Kosovës

Prioriteti i Kosovës gjatë viteve të ardhshme të zbatimit të Strategjisë është të krijojë një klimë të favorshme për inovacione dhe të nxisë investimet e sektorit të biznesit në aktivitetet e inovacionit për të zhvilluar produkte, shërbime dhe teknologji të reja që do të mundësojnë modernizimin dhe diversifikimin e ekonomisë kosovare. Identifikimi i katër Fushave Prioritare mund të ndihmojë në modernizimin e investimeve dhe përpjekjeve të lidhura me zbatimin e Strategjisë.

7 PROCESI DHE MONITORIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për Inovacion dhe Ndërmarrësi është korniza bazë e cila përcakton objektivat dhe prioritetet për përmbushjen e qëllimeve strategjike. Strategjia përcakton politikat dhe masat për industrinë dhe akademinë, e cila do të jetë e dobishme për zhvillimin ekonomik, konkurrencën industriale dhe mirëqenien sociale. Procesi i zbatimit të Strategjisë përfshin një mekanizëm të pashmangshëm, në bazë të të cilit MIN-ja do të jetë në gjendje të përcaktojë politikat e saj, të ndajë detyrat dhe të ndërmarrë veprime specifike, si dhe të monitorojë zbatimin e Strategjisë.

Procesi i zbatimit do të kryhet sipas aktiviteteve të përcaktuara në shtylla, dhe përcakton afatet kohore për zbatimin e tyre, institucionin përgjegjës për një zbatim të tillë, dhe institucionet që mbështesin aktivitetet, koston e zbatimit dhe koston e përgjithshme të planifikuar dhe burimin e financimit.

Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit do të kryhen duke shërbyer dy funksione themelore:

- informimin rreth asaj se çfarë ka arritur strategjia, dhe nëse zbatimi është në rrugën e duhur, si dhe duke e bërë këtë informacion të disponueshëm për vendimmarrësit;
- mbështetjen e përfshirjes konstruktive dhe pjesëmarrjes së palëve të interesit përmes komunikimit transparent dhe promovimin e ndërtimit të besimit. Mekanizmi monitorues duhet të jetë në gjendje të kapë dhe të ndjekë ndryshimet përkatëse të pritura, që janë parashikuar në secilën prej shtyllave tematike, me anë të një zgjedhje të përshtatshme të rezultateve përfundimtare/ rezultateve dhe treguesve të kontekstit.

Qasja e monitorimit dhe vlerësimit do të luajë një rol të rëndësishëm. Nga njëra anë, ajo do inkurajojë komunikimin e rregullt midis akterëve të sistemit të inovacionit. Në anën tjetër, do t'u ofrojë akterëve të dhëna lidhur me rezultatet e ndërhyrjeve publike. Kjo gjë do kontribuojë në të mësuarit sistematik dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të politikave dhe programeve Kosovare të inovacionit, si dhe në ndërtimin e besimit. Për më tepër, do të lehtësojë dialogun midis akterëve nga nivele të ndryshme.

Qasja e monitorimit dhe vlerësimit përqendrohet në monitorimin e rezultateve dhe në kontributin e tyre në politikën e inovacionit dhe ndërmarrësisë në tërësi, në vend që të monitorojë absorbimin e alokimeve financiare. Prandaj, sistemi i monitorimit duhet të lejojë, nëpërmjet monitorimit të treguesve të përzgjedhur të rezultateve, vlerësimin e tyre kundrejt objektivave dhe të ndryshojë qasjen e politikës në rast të dështimit.

7.1 Përgjegjësitë dhe Detyrat

Zbatimi efektiv i Strategjisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi do të jetë çelësi i suksesit. Prandaj, procesi i zbatimit përfshin marrëveshjet e duhura institucionale dhe qasjet e monitorimit. Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) është përgjegjëse për monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të Strategjisë, dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë efikase aktivitetet e përcaktuara në planin e veprimit.

Veprimet kryesore nën udhëheqjen e MIN-së janë:

- Krijimi i një mekanizmi efektiv të monitorimit dhe raportimit në përputhje me kërkesat e monitorimit dhe raportimit dhe të sigurojë zbatimin e tij.

- Mbledhja e informatave nga ministritë pjesëmarrëse në zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të saj të veprimit.
- Përgatitja e raporteve të rregullta vjetore për zbatimin e dokumentit strategjik, dhe raporteve gjashtëmujore për zbatimin e planit të veprimit.
- Organizimi i punës së organit ndërmintor të koordinimit, për të cilin ofrojnë funksione të sekretariatit.
- Inicimi i diskutimeve lidhur me çështjet problematike, nëse është e nevojshme.
- Publikimi i raporteve të rregullta në ueb faqen e ministrisë pas miratimit të saj nga organi përkatës.

Të gjitha këto aktivitete të inicuar nga MIN-ja do të operacionalizohen në bashkëpunim të ngushtë dhe komunikim me Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Ky Këshill është organi më i përshtatshëm për monitorimin e procesit të zbatimit përmes:

- Mbledhjeve dhe diskutimeve të rregullta mbi progresin e arritur në zbatimin e objektivave, treguesve dhe veprimeve të dokumentit përkatës strategjik.
- Identifikimit të sfidave dhe pengesave për zbatimin e suksesshëm, dhe propozimin e masave korrigjuese që duhet të ndërmerren nga MIN.
- Diskutimeve dhe miratimeve të raporteve të rregullta

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2016): Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike 4/2016. URL: https://bqk-kos.org/repository/docs/2015/CBK_Macroeconomic%20developments%204.%20doc.pdf (qasur më 15 tetor 2018).

Elliott, J. E. (2017): Hyrje. Në: Schumpeter J. A. (2017): Teoria e Zhvillimit Ekonomik, f. VII-LX..

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (2016): Strategjia për Kosovën. Siç është miratuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e tij më 4 tetor 2016. URL: <http://www.ebrd.com/documents/strategy-and-policy-coordination/strategy-in-kosovo.pdf> (qasur më 16 tetor 2018).

BE. (2013). Rregullorja (BE) Nr. 1303/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 dhjetor 2013. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. L.347, 320-469. (qasur më 23 nëntor 2018).

Foray, D., David, P.A. and Hall, B. (2009). Smart specialisation: the concept, Knowledge for Growth: Prospects for Science, Technology and Innovation, Report, EUR 24047, Bruksel, Komisioni Evropian.

Foray, D., Keller, M., Bersier, J. and Meier zu Köcker, G. (2018). Transformative Activities for Smart Specialisation: Considerations on a Workshop Methodology. Working paper EPFL / HES-SO HEIA-FR / ClusterAgentur. <https://bit.ly/2yuTEAX>.

Hallberg, K., 2000. A market-oriented strategy for small and medium scale enterprises (Vol. 63). Publikim nga Banka Botërore.

Hisrich, R. D., Peters, M. P. & Shepherd, D. A. (2005): Entrepreneurship.

Keller, M., Reingruber, I., Dermastia, M., Bersier, J., Meier zu Köcker, G. (2018) Smart Specialisation Strategies and Clusters – An Innovation Model for Transformative Activities, https://www.clusterportal-bw.de/fileadmin/media/Download/Downloads_News_Presse/Keller_et_al._2018_.pdf

Meier zu Köcker, Dermastia, Keller, (2017), Strategic Alpine Space Areas for Cross-regional Cooperation, publikuar nga S3-4AlpProject, doi:10.23776/001

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) (2018): Defining innovation URL: <https://www.oecd.org/site/innovationstrategy/defininginnovation.htm> (qasur më 15 tetor 2018).

Republika e Kosovës (2016): Strategjia e Kosovës për TI. URL: http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Kosovo_IT_Strategy.pdf (qasur me 18 tetor 2018).

INSTITUTI RIINVEST (2017): Ndërmarrësia e Grave – Analiza e të berit biznes në Kosovë. URL: http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens_Entrepreneurshi_p1510307815.pdf (qasur me 24 tetor 2018).

Tataj, D. (2015): Innovation and Entrepreneurship – A Growth Model for Europe Beyond the Crisis.

SHTOJCA

Tabela 1: Strukturimi i institucioneve/organizatave që mbështesin sipërmarrjen dhe inovacionin

Institucionet/orga nizatata/agjencitë/d onatorët	Synimi i politikave	Asistenca teknike	Asistenca financiare	Mbështetja e infrastrukturës
<p>Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve, Prizren</p>	<p>ITP është një kompani Kosovaro-Gjermane dhe është aktive në një prej tre sektorëve kryesorë (firmat e bazuara në teknologji/TIK, Përpunimi agro/ushqimor, industria kulturore dhe krijuese) si dhe krijon vende të reja të punës, komercializon inovacionet nga aktivitetet e R&D, zhvillon ekonominë dhe ofron mundësi për AAP-në dhe të nxënit e orientuar në praktikë.</p> <p>ITP-ja është shumë më tepër se sa vetëm një park biznes klasik. Përveç afërsisë fizike, një atmosferë e fortë rrjetëzimi qëndron në zemër të ITP, e cila bazohet në bashkëpunim dhe burime të përbashkëta. ITP siguron lidhje të ngushta ndërmjet qiramarrësve, si dhe ndërmjet menaxhmentit të parkut dhe qiramarrësve, duke ofruar një ambient që nxit sinergji ndërmjet sektorit privat, institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional dhe aktiviteteve të inovacionit</p> <p>Firmat e bazuara në teknologji/TIK Përpunimi agro/ushqimor Industria kulturore dhe krijuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet e lidhura me mbështetjen e biznesit. Institucionet hulumtuese ose universitetet ofrojnë arsim të cilësisë së lartë të orientuar drejt aplikimit, i përshtatur me nevojat e tregut të punës, si dhe krijojnë lidhje me industrinë për studentët e tyre (përmes bashkëpunimit në formë të praktikave, hulumtimeve, etj.). • Shkollat e dyfishta të arsimit profesional dhe qendrat e trajnimit ofrojnë arsim dhe aftësim profesional të përshtatur me nevojat e tregut të punës dhe bashkëpunon ngushtë me bizneset e vendosura në park. 		<ul style="list-style-type: none"> • Inkubatorët dhe hapësira e biznesit për të rinjtë ofrojnë pajisje të duhura dhe ekspertizë për studentët, të diplomuarit dhe sipërmarrësit që aspirojnë, si dhe promovojnë aktivitetet sipërmarrëse, ndër-sektoriale, ndër-vepruese dhe partneritete.

		Akterët e shoqërisë civile të fushave përkatëse ofrojnë arsimim jo formal dhe kontribuojnë me aktivitete shoqërore dhe kulturore në park.		
KOSME (Swiss & ADA) PROGRAMI I KOSOVËS PËR PROMOVIMIN E NVM-ve (KOSME)	<p>Objektivi i përgjithshëm Të kontribuojë në zhvillimin e sektorit privat të orientuar në treg në Kosovë dhe të nxisë konkurrueshmërinë globale të NVM-ve të Kosovës në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>Objektivi specifik Të kontribuojë në përmirësimin e kushteve kornizë dhe në ofrimin e shërbimeve për NVM-të në Kosovë si rezultat i qasjes së zgjeruar për të financuar dhe profesionalizuar shërbimet e zhvillimit të biznesit të ofruara nga Agjencia Kosovare për Mbështetje të NVM-ve, me theks të veçantë në krijim e mundësive për të varfrit, burrat dhe gratë, të rinjtë dhe minoritetet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet për zhvillimin e bizneseve • Skema e këshillimit (VCS) është ri-organizuar dhe ri-themeluar për të ndihmuar NVM-të me shërbime konsultimi dhe trajnimi. Ri-organizimi i Këshillit të Konsulentëve të Biznesit është mbështetur edhe në kualifikimet, trajnimet dhe certifikimin me CMC për konsulentët. 	Përmirësimi i qasjes në financa Mbështetja e krijimit të Skemës së Garancisë së Kredive për të përmirësuar qasjen e NVM-ve në financa. Zhvillimi i strategjisë së financimit për Fondin e Garancisë së NVM-ve dhe zbatimin e masave për ngritjen e ndërgjegjësimit të CGS. Ofrimi i trajnimit për stafin e MTI/AMNVM për CGS dhe trajnime për punonjësit e institucioneve financiare dhe ofrimi i mbështetjes në zbatimin e fazës fillestare të CGS-së.	N.a.
BERZH (ish- TAM / BAS)	Ky program financohet nga BERZH, Luksemburgu, Suedia dhe nga fondi i posaçëm i Aksionarëve nga BERZH. Linjat e dedikuara të kredisë në vlerë prej 8 milion € që mbulojnë rrezikun e parë dhe të dytë të humbjes dhe	134+ gra sipërmarrëse të pajisura me shërbime bazë të diagnostifikimit (diagnostic) duke identifikuar financimin	BERZH-ja ka lidhur marrëveshje me TEB bankën në Kosovë për të administruar këtë skemë të instrumentit	

	<p>asistencën teknike për bankat partnere. BERZH-ja ka hartuar një skemë të kredive për të mbështetur femrat sipërmarrëse si pjesë e pilot projektit të tyre në rajon.</p>	<p>e biznesit të tyre dhe njohuritë praktike, 45+ gra janë trajnuar përmes kurseve për shkathtësitë sipërmarrëse, 40+ gra udhëheqëse të sipërmarrjeve kanë pranuar këshilla biznesore dhe ekspertizë industriale.</p> <p>Asistenca teknike për institucionet financiare pjesëmarrëse por gjithashtu mbështetja e NVM-ve në pronësi nga gratë dhe të menaxhuara nga gratë në qasjen e njohurive praktike, shërbimeve jo financiare të zhvillimit të biznesit dhe mundësive të rrjetëzimit, dhe përmirësimit të burimeve njerëzore në NVM-të e udhëhequra nga gratë</p>	<p>kreditor. BERZH-ja do të mbulojë deri në 10% të portfolios së përgjithshme të kredive në rast të vonesës. Procesi i shqyrtimit përbëhet nga disa faza në vazhdim. Së pari femrat fillestare sipërmarrëse paraqesin idetë e tyre biznesore tek paneli i ekspertëve të BERZH-it. Pastaj, aplikuesit e suksesshëm do të shqyrtohen nga banka TEB. Pas pranimit të kredisë kërkesa kolaterale reduktohet për 50% për aplikuesit e suksesshëm. Pas ripagimit të kredisë, 10% e vlerës së kredisë i kthehet grave sipërmarrëse.</p>	
<p>Qendra e Inovacionit të Kosovës (ICK)</p>	<p>Qendra e Inovacionit të Kosovës (ICK) është një qendër qëllimi i së cilës është të ndërlihdë komponentin e hulumtimit dhe zhvillimit të fushave shkencore me sektorin e biznesit, duke u fokusuar në krijimin e mundësive të reja të punës të orientuara drejt së ardhmes, bazuar në njohuri dhe në teknologji të re.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtori • Ndërlidhje (Matchmaking) • Kamp i trajnimit (Boot camps) • B2B • Aplikimi (Pitching) 	<ul style="list-style-type: none"> • Qasja për grante 	<ul style="list-style-type: none"> • Vendet e inkubacionit për startup • Hapësirat për bashkëpunim • Elevator Lab • Një ndërmarrje shoqërore dhe qendra e komunitetit për teknologji

	<p>Qendra e Inovacionit të Kosovës (ICK) u themelua për të mbështetur ndërmarrësinë, inovacionin dhe zhvillimin e biznesit i bazuar në tregti, me fokus në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Kjo qendër mbështet kompanitë fillestare si dhe ato ekzistuese me mundësinë për rritje.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Seminaret e realizuar përmes internetit - Webinar • Konkurrenca për ide • Trajnim për start-up dhe kurset e specializuara të TIK-ut • Qasje në konferencat ndërkombëtare, panairët dhe B2B-të 		
<p>Qendra e Inovacionit Jakova - JIC</p>	<p>Qendra e Inovacionit Jakova JIC është një organizatë jo fitimprurëse e themeluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me komunën e Gjakovës. Kjo qendër shërben si inkubator biznesi me mision promovimin dhe mbështetjen e sipërmarrësve të rinj në ndërtimin dhe zhvillimin e kompanive të reja. Qendra e Inovacionit Jakova dëshiron të jetë e pozicionuar në një formë të tillë të tregut që përdor ide të mëdha, njerëz dhe burime për të ndikuar në ekonomi dhe për të zbuluar potencialin e vërtetë për sipërmarrësit e rinj në Kosovë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështet programet e konsultimit, trajnimit në fushat e tilla si menaxhimi biznesor, hulumtimi i tregut, financat, marketingu dhe shumë fusha të tjera • Kampi i trajnimit për sipërmarrësi • Bashkëpunimi me vendorë dhe ndërkombëtarë të ndryshëm i mundëson qendrës që tu hapin rrugë shumë kompanive të reja të debutojnë në tregun ndërkombëtar 		<p>Inkubatori ofron mbështetje për kompanitë e reja dhe inovative duke ofruar hapësirë/zyra për punë me qasje 24 orësh</p>

<p>Qendra për Ndërmarrësi dhe Zhvillim Ekzekutiv (CEED) / SEAF, USAID, FMO</p>	<p>CEED jo vetëm që u ofron sipërmarrësve njohuri praktike për biznes përmes programeve të saj mbështetëse por gjithashtu edhe lidh pjesëmarrësit me mentorët dhe me një komunitet të ndërmarrësve të cilët mund të ndihmojnë biznesin e tyre të kalojnë në një nivel më lart. Kombinimi i përgjithshëm i lidhjeve të tregut, angazhimi i komunitetit, ngritja e kapaciteteve dhe qasja në kapital dallojnë CEED-in nga të tjerët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i aftësive përmes mësimi kolegjial • Ofrimi i qasjes në financa • Zhvillimi i marrëdhënieve përmes mentorimit • Mentorim dhe konsulencë për rritjen e biznesit. Avancim të aftësive për zhvillimin e një modeli të suksesshëm të biznesit si dhe konsulencë për zhvillimin e biznesit • Takime B2B me kompanitë lokale/regjionale, si dhe forume dhe konferenca për investime që mbahen në vend dhe ndërkombëtarisht 	<p>CEED Startup Accelerator Rrisni biznesin dhe gjeni investitorët e duhur! Startup Accelerator. Është program 3-6 mujor ku bizneset gjejnë mbështetjen e nevojshme për një rritje të shpejtë.</p> <p>CEED Startup Accelerator është për ndërmarrësit që kanë një biznes të regjistruar operativ nga 1 muaj deri në 3 vjet, dhe dëshirojnë të përmirësojnë modelin e biznesit si dhe rritjen e të ardhurave të biznesit.</p> <p>Lidhje me investitorët lokal dhe ndërkombëtar, si dhe me institucionet financiare</p>	<p>HAPËSIRA E BASHKËPUNIMIT</p>
<p>Qendra për Mbështetjen e Bizneseve në Kosovë (BSCK)</p>	<p>Të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e start-up-eve dhe NVM-ve duke promovuar ndërmarrësinë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Programi i trajnimit për ndërmarrësi dhe start-up përmes shkollës së ndërmarrësisë • Trajnimi dhe mentorimi biznesor • Konsulencë për start-up • B2B dhe panairë tregtare 	<ul style="list-style-type: none"> • Grantet me skemat e bashkë-financimit të financuara nga donatorët përmes donatorëve 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Rrjetëzimi • Planet e biznesit të lidhura dhe pitching • Hulumtimi dhe analiza e politikave 		
Management Development Associate (MDA) foundation	Krijimi i vendeve të punës përmes mbështetjes së krijimit dhe rritjes së start-ups. Ndërmarrësit do të promovohen përmes një game aktiviteteve dhe shërbimeve për të mbështetur rritjen e kompanive të tyre, të tilla si konsultimi, asistencë teknike dhe financiare për t'i bërë ato të qëndrueshme	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnim në zhvillimin e ideve të start-up të biznesit dhe planit të biznesit • Mbështetje teknike dhe administrative përmes konsultimit në aspektin ligjor financiar dhe aspekteve tjera të start-up 	<ul style="list-style-type: none"> • Rrjeti i investitorëve të "Engjëjve" të Biznesit (Business Angel) lehtëson ndërlidhjen ndërmjet investitorëve dhe start-up me potencial të lartë për partneritetet në investimet financiare. Investorët "Engjëj" do të investojnë kapital në start-up dhe në kthim pranojnë aksione në kompanitë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësira e inkubatorit për start-up
D&D Business Support Centre	D&D Business Support Center është kompani konsulente, e themeluar në vitin 2008, e cila ofron shërbime profesionale (konsulencës) për institucionet publike, kompanitë privatë, start-ups, të papunësuarit, ndërmarrësit e rinj, gratë ndërmarrëse, minoritetet dhe grupet e tjera të marginalizuara si dhe organizatat jo qeveritare, donatorët,	<ul style="list-style-type: none"> • Trajnimi për mbështetjen e bizneseve • Mentorim dhe trajnim • Zhvillimi dhe përditësimi i planeve të biznesit 		
VentureUP/Universiteti i Prishtinës	Venture-UP është inkubatori i parë në Universitetin e Prishtinës që u jep mundësinë studentëve të UP-së të themelojnë dhe të zbatojnë idetë e tyre start-up. Kjo do të nxisë mentalitetin e ndërmarrësisë dhe arsimimin përgjatë gjithë fakulteteve të UP-së me fokus specifik në Inxhinieri, Mjekësi, Bujqësi dhe Ekonomi. Venture-UP gjithashtu u jep mundësi hulumtuesve në Universitetin e Prishtinës që t'i komercializojnë produktet e hulumtimit në treg.	<ul style="list-style-type: none"> • Shërbimet për mbështetjen e bizneseve për start-up nga UP-ja • Rrjetëzimi dhe lidhja me investitorët • Mentorimi dhe trajnimi 		Hapësirë e përbashkët për ndërmarrje të reja

	VentureUP mbështetet nga programi i USAID-it “Transformational Leadership-Citizens Corps”			
Gjirafa.com	<p>Gjirafa Lab është ndërtuar nga Gjirafa, Inc me mbështetjen e “Startup Yard” dhe “Rockaway Capital” dhe e asistuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), me qëllim të ndërtimit të ekonomisë së internetit në Kosovë dhe rajon. Sipërmarrësit do të kenë një mundësi për të transformuar idetë e teknologjisë / produkteve të tyre në biznese të suksesshme online dhe zgjidhjen e problemeve reale për shoqërinë.</p> <p>Kriteret e përzgjedhjes në faqen e internetit tregojnë se startup-et do të përzgjidhen në bazë të tregut të synuar (duke synuar Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë dhe rajonin), ekipit, ndikimit të ekonomisë në internet, tregut, teknologjisë, etj., ndërsa startup-eve të përzgjedhura do t’u ofrohet një hapësirë për të zhvilluar më tej idenë e tyre dhe mentorim, edhe pse mentorët nuk janë bërë publikë ende.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mentorimi i biznesit • Përvoja, mbështetja teknike dhe afariste 	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje financiare në formën e investitorëve "Engjëj" në këmbim të kuotës së pjesëmarrjes aksionare 	Gjirafa Lab, një inkubator rajonal për start-up, ofron hapësirë për start-up-et dhe mbështetjen përkatëse
Inkubatori Virtual i Kosovës dhe Qendra e Start-up, UBT	Ofron mbështetje për studentët ndërmarrës të UBT-së dhe të tjerë me ndërmarrje start-up	Konkursi i planit të bizneseve për studentët e UBT-së		
Innovation Lab Kosovo	Financuar nga UNICEF , Innovations Lab Kosovo po ndihmon UNICEF-in dhe partnerët që të ri-shohin zhvillimin. Një njësi e UNICEF-it në Kosovë, Laboratori, është shtëpia e një ekipi shumë të disiplinuar duke përfshirë menaxherët e projekteve, inxhinierët e softuerëve, praktikuesit e përkrahjes, dizejnatoret, ndërmarrjet sociale, edukatorët, specialistët e komunikimit dhe marketingut, dhe dizejnatoret e grafikës dhe uebit.	<p>Trajnime dhe punëtori për inovacion, komunikim.</p> <p>STARTUP: PUNËTORITË E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE</p>		

	<p>Laboratori punon me adoleshentë dhe të rinj (14-24 vjeç) me theks në grupet e marginalizuara, të cenuara dhe të përjashtuara nga shoqëria (komunitet pakicë; komunitetet rurale; komunitetet në varfëri; adoleshentët dhe personat me aftësi të kufizuar). Kjo kontribuon në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e mundësive në mesin e të rinjve më të marginalizuar të Kosovës që të kërkojnë dhe sigurojnë pjesëmarrje si në fuqinë punëtore ashtu edhe në formimin e politikave dhe proceset vendimmarrëse</p>			
<p>Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK),</p>	<p>Qeveria dhe disa donatorë multi-nacional kanë krijuar FKGK-në, që është vendor dhe i pavarur. FKGK-ja luan rol kryesor në lehtësimin e barrës për NMVM-të që ato të sigurojnë më shumë financim për rritjen e tyre. FKGK-ja do t'i ndihmojë institucionet financiare që ato t'i japin kredi NMVM-ve të përshtatshme që mund të mos jenë plotësisht të kualifikuara pa garanci që të marrin kredinë, ose, nëse kanë kredi, mund të mos kualifikohen për të marrë financim shtesë që iu nevojitet për rritje. Pengesat të cilat FKGK-ja do të ndihmojë të tejkalohen përfshijnë NMVM-të që nuk kanë kolateral të përshtatshëm ose që kanë regjistër të kufizuar kreditor dhe historisë kreditore</p>		<p>Instrumenti i qëndrueshëm për garantimin e kredive lëshon garanci kreditore portofoli për institucionet financiare për të mbuluar deri në 50% të rrezikut për kreditë e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NMVM-të)</p>	
<p>USAID, EMPOWER</p>	<p>Projekti bashkëpunon me kompani dhe individë të përzgjedhur me kujdes në mesin e sektorëve me potencial për zhvillim për t'iu ndihmuar atyre që të identifikojnë dhe lidhen me mundësitë që paraqiten në treg, të rrisin produktivitetin, të avancojnë shkathtësitë për menaxhim dhe të fuqisë punëtore, si dhe të zgjerojnë qasjen në financa. Përmes aktiviteteve dhe intervenimeve që bën, projekti EMPOËER Sektori Privat adreson nivelet e larta të varfërisë dhe papunësisë,</p>	<p>Projekti ofron mbështetje financiare për bizneset për rritjen dhe përmirësimin e prodhimit, zgjerimin e lidhjeve të blerësve, programe specifike të trajnimit dhe praktikave</p>	<p>Të ofruara subvencione të grantit</p>	

	varësinë e tepërt nga importet dhe sektorin e pazhvilluar të eksportit			
Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE), Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim	Fokusi i projektit është të promovojë punësimin duke ndihmuar kompanitë dhe të vetë punësuarit në turizëm, përpunim të ushqimit (fruta dhe perime), dhe produktet pyjore jo-drusore) dhe shërbimet shëndetësore private.	Trajnimi, ngritja e kapaciteteve	Grantet dhe subvencionet për	
Prishtina Hackerspace ²⁴	Prishtina Hackerspace është një hapësirë eksperimentuese, bashkëpunuese e hapur ekskluzivisht për qëllime teknologjike, edukative, kulturore dhe shkencore. Qëllimi i hapësirës është që të sigurojë hapësirë të punës, pajisje dhe burime të tjera për përdorim të përbashkët nga të gjithë anëtarët.	Prishtina hackerspace mësim të vazhdueshëm pas orarit mësimorë nëpërmjet punëtorive, klasave, seminareve dhe mentorimit, si dhe krijon një mjedis të sigurve dhe të hapur për eksperimentim në teknologji dhe art	Përfitimet direkte dhe indirekte në zhvillim ekonomik nga hackerspace-i do të fillojnë që nga zhvillimi i aftësive të individëve për punësim, vetë-punësimi, idetë spin-off për biznese, e deri tek tërheqja e sipërmarrjeve dhe kapitalit të grantit dhe do të ndihmojnë në ndërtimin dhe zbatimin e fuqisë punëtore teknologjike dhe krijuese në Kosovë. Që nga data 1 janar 2017 ata kanë 231 mbështetës të cilët zotuan 16,994\$ që të ndihmojnë sjelljen e këtij projekti në jetë	Hapësira bashkëpunuese

²⁴ <https://www.kickstarter.com/projects/1731685895/lets-build-a-hackerspace-in-kosovo>

Kutia I: Iniciativat dhe mbështetja e "engjëjve" të biznesit (business angels) - Shembuj të "engjëjve" të biznesit (business angels) dhe platformat crowdfunding

- **Rrjeti Kosovar i Engjëjve të Biznesit-KOSBAN** është themeluar në vitin 2014 dhe mbështetet nga Kolegji Universum dhe nga BiD Network, dhe ka për qëllim fuqizimin e komunitetit start-up në Kosovë duke i sjelle së bashku ndërmarrësit dhe investitorët engjëj nga Kosova dhe jashtë saj. KOSBAN synon të krijoj një platformë nga investitorët si dhe investitorët të cilët kërkojnë të marrin të gjitha përfitimet që vijnë së bashku me investimet engjëj. Për më tepër, KOSBAN kërkon që t'i përgatisë investitorët (sidomos investitorët e virgjër) në Kosovë përmes punëtorive të ndryshme që u mundëson atyre të njohin mënyra të ndryshme të investimit të kapitalit të tyre në start-up që kanë potencial për rritje dhe rezultojnë në kthime të larta. Përmes mobilizimit të financave për startup-et në Kosovë, kështoj KOSBAN stimulon fillimin dhe rritjen e start-up-eve së bashku me mbështetjen për krijimin e vendeve të punës.
- **Gjirafa Lab**²⁵ është një skemë tjetër privatë e drejtuar nga investitorët engjëj. Gjirafa Lab është fabrike e start-up e themeluar për ndërmarrësit e internetit të cilët nuk kanë qasje në burime dhe treg. Si fabrikë e start-up, laborator i ofron hapësirë, mentorim, rrjetëzim, teknologji, shfaqjen e talenteve, dhe financim për sipërmarrësit konkurrent të internetit, duke krijuar kështu zgjidhje për tregun e Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Ndryshe nga të tjerët, Gjirafa Lab është bërë nga njerëz të cilët e kanë bërë një startup më parë. Gjirafa Lab është ndërtuar nga Gjirafa, Inc, e ndihmuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), me qëllimin e ndërtimit të ekonomisë së internetit në Kosovë dhe rajon. Sipërmarrësit do të kenë një mundësi për të transformuar idetë e teknologjisë / produkteve të tyre në biznese të suksesshme online dhe zgjidhjen e problemeve reale për shoqërinë. Gjirafa ofron mbështetje financiare për start-up në sektorin e TIK-ut, në formën e investitorëve Engjëj, në këmbim kuotave të pjesëmarrjes aksionare. Gjirafa është e përqendruar kryesisht në sektorët e TIK-ut dhe lidh start-up me qendrën e inkubatorit dhe kërkon (seed) fonde me mbështetje shtesë. Ka ndërtuar një platformë online për procesin e aplikimit dhe shqyrtimit të ideve inovative përmes thirrjeve të hapura.
- **MDA Rrjeti i investitorëve engjëj të biznesit** lehtëson lidhjet ndërmjet investitorëve dhe start-up me potencial të lartë në Kosovë për partneritetet në investimet financiare, rrjetëzimin, teknologjinë dhe transferimin e njohurive praktike për vendosjen e suksesshme të produkteve / shërbimeve të kërkuara. Investitorët engjëj do të investojnë kapital në Start-up dhe si kthim do të marrin aksione të kompanive.
- **Highlight Ventures.** Leo Blakaj, themeloi engjëj ndërkombëtar të bizneseve "Highlight Ventures". Kompania është një investitor aktiv në Evropë, e fokusuar në kompanitë në fazën e hershme. Investimet përfshijnë markat si Entermedia, Zetta, Bzzz, Vello, Digital Rebellion, Punetori dhe më së fundi The Yellow Bell Labs që bashkon komunitetet start-up në kampuset e saj dhe fokusohet në ndërtimin e start-up-eve të reja të teknologjisë që nga e para. Gjatë shkollës së mesme Leo ishte bashkëthemelues dhe udhëheqës i Entermedia Group, një agjenci marketingu që ka fituar çmime për prodhimin e videove që ka zyre në Nju Jork, Berlin dhe Prishtinë, si dhe themeloi kompaninë pioniere për web-hosting Hapsira Networks. Ai është anëtar themelues në rrjetin kosovar të engjëjve të biznesit - që është anëtar i EBAN-it dhe i odës ekonomike Gjermano-Kosovare. Leo ka një interes në gjeneratën e ardhshme të ekonomisë dhe inteligjencën artificiale. Ai ka përfunduar mastër në IEDC dhe ka përfunduar studimet në Institutin Rochester të Teknologjisë.
- **Prishtina hacker Space** u ofron përfituesve të Hackerspace shërbime mbështetëse që fillojnë që nga zhvillimi i aftësive të individëve për punësim, vetë-punësimi, idetë spin-off për biznese, e deri tek tërheqja e sipër-marrjeve dhe kapitalit të grantit dhe do të ndihmoj në ndërtimin dhe zbatimin e fuqisë punëtore teknologjike dhe krijuese në Kosovë. Organizata shfrytëzon platformën crowdfunding. Që nga janari i vitit 2017 ata kanë 231 mbështetës të cilët premtuan 16,994\$ që të ndihmojnë sjelljen e këtij projekti në jetë

²⁵ <http://gjirafalab.com/>

- **KOSOVA Idea platform crowdfunding** është iniciativa e parë (edhe pse është regjistruar në Bazel, Zvicrës) dhe thirret KOSOVA ideas²⁶ (Verein/asociacioni) është OJQ jo fitimprurëse në Bazel, Zvicër. Kjo OJQ është e liruar nga tatimet dhe donacionet janë të zbritshme nga tatimi sipas ligjit dhe rregulloreve të kantonit të qytetit të Baselit, Zvicër. Mbledh fonde për projekte të mbështetësve dhe i shpërndan ato në harmoni me rregullat tona tek pronarët e projekteve. Organizata zhvillon dhe menaxhon platformën, rekruton stafin, bën marrëveshje me partnerë, investon në softuerin dhe infrastrukturën e nevojshme dhe ri-investon të gjitha fitimet për të zhvilluar më tej dhe për të promovuar platformën www.kosovaideas.com. Të gjitha fondet e pranuar nga mbështetësit për ndonjë projekt specifik do të shpërndahen kështu, 90% tek pronari i projektit, 10% tek KOSOVA ideas GmbH duke i lejuar kështu që t'i mbulojë shpenzimet e ndërlidhura me transferet bankare (3-6%) dhe pjesa tjetër 4-7% për t'i mbuluar shpenzimet e menaxhimit, zhvillimit dhe promovimit të platformës.

²⁶ <https://kosovaideas.com>